



HEROI I VERTETE
ËSHTE AI QË FAL.

xxiii associazione
Comunità Papa Giovanni XXIII
Komuniteti Papa Xhovani XXIII

**DOKUMENT I PËRSHKRIMIT
TË FENOMENIT “HAKMARRJA”
E “GJAKMARRJA”
PËR SENSIBILIZIMIN E INSTITUCIONEVE
SHQIPTARE E NDËRKOMBËTARE
- BOTIMI III -**



KONTAKTE:

**Operazione Colomba -
Korpusi i jodhunës dhe pro paqes i shoqatës
Comunità Papa Giovanni XXIII**

Itali:

Website: www.operazionecolomba.it

Email: operazione.colomba@apg23.org

Tel: +39 0541 29005

Facebook: Operazione Colomba

Shqipëri:

Website: www.kundergjakmarrjes.org

Email: operazionecolomba.al@apg23.org

Tel: +355 69 4007283

Facebook: Kundër Gjakmarrjes



Operazione Colomba – Korpusi i jodhunës dhe pro paqes

*DOKUMENT I PËRSHKRIMIT TË FENOMENIT “HAKMARRJA” E
“GJAKMARRJA” PËR SENSIBILIZIMIN E INSTITUCIONEVE SHQIPTARE E
NDËRKOMBËTARE
-BOTIMI III-*

Dokument i hartuar në dhjetor 2017 nga
Operazione Colomba –korpusi i jodhunës dhe pro
paqes i shoqatës Comunità Papa Giovanni XXIII –
Komuniteti Papa Xhovani XXIII¹

1 Azhornimi i “Dokument i përshkrimit të fenomenit “hakmarrja” e “gjakmarrja” për sensibilizimin e institucioneve shqiptare e ndërkombëtare.



TREGUES

Prezantim	4
1. Shkaqet e fenomenit dhe konteksti	6
2. Karakteristika, dinamika dhe pasoja e fenomenit	11
3. Shpërndarja gjeografike dhe numerike e fenomenit të gjakmarrjes	20
4. Roli i institucioneve shqiptare në luftën ndaj fenomenit të gjakmarrjes	27
4.1 Afrimi i institucioneve shqiptare ndaj fenomenit të gjakmarrjes	29
4.2 Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shqiptare e Operazione Colomba	31
5. Rekomandimet	34
5.1 Rruge ndërmjetësimi	35
5.2 Procesi i pajtimit të përgjithshëm	38
Bibliografia	42



DOKUMENTI I PËRSHKRIMIT TË FENOMENIT “HAKMARRJA” E “GJAKMARRJA”² PËR SENSIBILIZIMIN E INSTITUCIONEVE SHQIPTARE E NDËRKOMBËTARE

Hartuar nga Operazione Colomba, Korpusi i jodhunës dhe pro paqes i shoqatës
Comunità Papa Giovanni XXIII³.

- 2 Në dokument rastet e “hakmarrja” e “gjakmarrja” janë të identifikuar me termin “fenomeni i gjakmarrjes”. Studimi përqendrohet, në veçanti, në zonën veriore të vendit, ku Operazione Colomba është e pranishme, pa përfshirë krejtësisht edhe pjesët e tjera të Shqipërisë.
- 3 Comunità Papa Giovanni XXIII vepron në nivel ndërkombëtar nëpërmjet realizimit të projekteve të adresuara në zonën e gjerë të përjahtimit social. Stili me të cilin Komuniteti çon përpara aktivitetet e veta bazohet në bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të jetës me të varfrit dhe për heqjen e shkaqeve që krijojnë situata të padrejtësisë. Komuniteti është i pranishëm në rreth 40 vende të botës me shtëpi familje, kooperativa sociale, qendra ditore, bashkësi terapeutike, shtëpi vëllazërimi dhe forma të tjera grumbullimi. Shoqata është e pranishme në Tiranë me një strukturë pranimit për të pastrehët, në fshatin Nënshat me një bashkësi terapeutike, në Shkodër me dy shtëpi familje e Operazione Colomba.



PREZANTIM

Operazione Colomba është Korpusi i jodhunës dhe pro paqes i shoqatës Comunità Papa Giovanni XXIII. Korpuset Civile të Paqes përbëhen nga grupe civilësh që hyjnë në kontekste konflikti të armatosur si pjesë të treta me qëllim që të mbrojnë të drejtat njerëzore, të mbrojnë civilët, parandalojë shkallëzimin e konfliktit, promovojë aktivitete të confidence building⁴, të ndërtojnë zgjidhje jo të dhunshme të konfliktit me mjete jo të dhunshme.

Nga viti 1992, Operazione Colomba realizon ndërhyrje jo të dhunshme të peacekeeping, peacemaking e peacebuilding civile në zona të ndryshme të konfliktit të armatosur (p.sh ish –Jugosllavia, Sierra Leone, Kosovë, Timor Est (Indonezi), Chiapas (Meksikë), Uganda e Veriut, etc.). Aktualisht Operazione Colomba po realizon ndërhyrjen e saj në Israel/Palestinë (nga 2002), Kolumbi (nga 2009), Shqipëri (nga 2010) e në Liban, përkrah refugjatëve sirianë (nga 2013). Ky dokument është hartuar duke filluar nga aktivitetet që Operazione Colomba realizon bashkë me viktimat e gjakmarrjes në pjesën veriore të Shqipërisë.

Nga viti 2005, kontakti i vendosur nga vepruesit italianë e shqiptarë të Shoqatës Comunità Papa Giovanni XXIII me familjet në konflikt u ka lejuar atyre të njohin, monitorojnë dhe denoncojnë praktikën e gjakmarrjes. Më pas, Shoqata Comunità Papa Giovanni XXIII, ka kërkuar ndërhyrjen e Operazione Colomba për të studiuar një strategji të zgjidhjes jo të dhunshme të konflikteve, i përshtatshëm për kontekstin e përcaktuar nga gjakmarrja.

Operazione Colomba garanton një prani fikse në zonën e Shkodrës nga marsi 2010 dhe një prani mujore në zonën e Tropojës nga tetori 2010. Prej më shumë se shtatë vitesh, vullnetarët e saj italianë e shqiptarë realizojnë ndërhyrje jo të dhunshme për të ndaluar dhe zgjidhur konfliktet që lindin nga grindjet ndërfamiljare.

Në Shqipëri, objektivi kryesor i ndjekur nga Operazione Colomba ka të bëjë me luftën ndaj fenomenit të gjakmarrjes dhe në tejkalimin e tij të përgjithshëm. Për të arritur këtë objektivi, vullnetarët e Korpusit të jodhunës e pro paqes realizojnë: rrugë të kapërcimit të zemërimit e të dhimbjes ndaj anëtarëve të familjeve viktime të fenomenit; rrugë ndërmjetësimi ndërmjet familjeve në konflikt me qëllim arritjen e një pajtimi mes palëve; fushata kombëtare sensibilizimi me qëllim garantimin e miratimit të masave për të luftuar këtë fenomen dhe për të krijuar një proces pajtimi të përgjithshëm që përfshin përdorimin e drejtësisë restauruese⁵; manifestime mujore në zonat e prekura më shumë nga fenomeni për të përhapur një kulturë jo të dhunshme të bazuar në respektin e të drejtave njerëzore; tryeza të rumbullakëta dhe takime publike për të përfshirë shoqatat dhe shoqërinë civile shqiptare me

4 Veprime që parashikojnë veprime që sigurojnë përfundimin e veprimeve relaksuese të synuara për të ulur nivelin e tensionit ndërmjet palëve dhe të rindërtojnë besimin në mënyrë që të përgatisë palën e dëmtuar për mundësinë e afrimit me palën tjetër.

5 Par. 5.1-5.2.



qëllim formulimin e propozimeve për zgjidhjen e problemit; përhapja e dëshmimeve të atyre që kanë zgjedhur pajtimin në vend të hakmarrjes; shoqërime jo të dhunshme për të garantuar një liri më të madhe lëvizjeje dhe për të pasur akses në kujdesin mjekësor për ata që rrezikojnë të pësojnë hakmarrjen; networking me shoqata të tjera që në vend punojnë mbi temën e gjakmarrjes për tu garantuar viktimave të fenomenit akses në mundësi edukative; monitorim dhe mbledhje të dhënash mbi përhapjen numerike e gjeografike të fenomenit për të zhvilluar një njohje gjithnjë e më të detajuar dhe të azhornuar të problemit; publikimii ndërhyrjeve jo të dhunshme të realizuara. Ndërhyrja e Operazione Colomba i destinohet subjekteve të përfshira drejtpërdrejt në grindje, shoqërisë civile shqiptare, institucioneve shqiptare dhe atyre ndërkombëtare si janë e tërë. Vullnetarët e saj frekuentojnë familjet në konflikt çdo ditë. Jeta në kontakt me to u jep mundësinë vullnetarëve të bashkëndajnë vështirësitë dhe rreziqet, duke favorizuar krijimin e një raporti besimi.



1. SHKAQET E FENOMENIT DHE KONTEKSTI

Në Shqipëri, praktika e gjakmarrjes fillimisht ka qenë të rregulluara në një kod të vjetër mesjetar të quajtur Kanun, i përdorur brenda shoqërisë fisnore. Nga shekulli i XIV, Kanuni ka mbledhur rregulla të shumta që disiplinonin çdo aspekt të jetës shoqërore të shqiptarëve. Themelet e Kanunit bazohen në një univers simbolik të karakterizuar nga konceptet e *nderit*, *besës*, *mikpritjes*, *burnisë* e *gjakut*. Në kulturën shqiptare, nderi është konsideruar faktori përbërës i marrëdhënieve midis individëve dhe komuniteteve të përkatësisë. Mbajtja e nderit të paprekur ishte një recetë individuale dhe kolektive absolute, pasi nderi ishte parimi që përcaktonte respektin social. Të mbrosh nderin tënd apo të fisit deri në vdekje ishte një detyrë morale. Kur nderi i një burri apo i fisit të tij fyhej, ai që kishte pësuar turpin mund të hakmerrej ndaj atij që e kishte shkaktuar. Hakmarrja shfaqej si një reagim i dhunshëm ndaj padrejtësisë së pësuar dhe nuk matej domosdoshmërisht me dëmin e pësuar. Nëse për shembull, hakmarrja bëhej me një vrasje, një vepër e tillë mund të kishte filluar gjakmarrjen. Fjala *gjakmarrja* përbëhet nga fjalët *gjak* e *marrja*, dhe do të thotë “marrja e gjakut”. Gjakmarrja mund të fillojë shpërthimin e një armiqësie sepse parashikonte vrasjen e atij që kishte bërë përpara një vrasje. Në shekuj praktika e gjakmarrjes u shtri edhe tek të afërmit meshkuj të viktimës së vrasësit: burrat që kishin lidhje gjaku me atë që kishte bërë një vrasje ishin përgjegjës për hakmarrje. Në këtë mënyrë, shkaktoheshin zinxhirë të gjatë vrasjesh ndërmjet fiseve të përfshira në grindje. Vrasja e një miku nën mbrojtjen e të zotit të shtëpisë, dhunimi i pronës private, mospagimi i një borxhi, i një kësti, joshja dhe përdhunimi i një gruaje ishin vetëm disa nga krimet që mund të fillonin një gjakmarrje.

Besa, ose “fjala e nderit”, është një premtim që ratifikon një marrëveshje të bërë. Ajo mund të ketë kuptime të ndryshme sipas konteksteve në të cilat bëhet. Në lidhje me *gjakmarrjen*, mosmbajtja e besës, domethënë e fjalës së dhënë, mund të fillojë një gjakmarrje. Për më tepër mund të jepet *besa* në kuptimin e “*armëpushimit*” për ata që janë të përfshirë në gjakmarrje. Në këtë rast, armëpushimi kuptohet si një periudhë lirie e sigurie, pak a shumë e gjatë, që familja e viktimës i ofron vrasësit e/ose familjes së tij, duke pezulluar përkohësisht ndekjen e gjakmarrjes. Pastaj nëse familja e viktimës këmbëngul që nuk do të japë armëpushim, vrasësi bashkë me gjithë familjen e tij duhet të ngujohet në strehën e vet në shenjë respekti ndaj dhimbjes së pjesës tjetër dhe për të mbajtur ulur kokën ndaj asaj që ka ndodhur. Sipas Kanunit, familja e shkelësit nuk duhej të dukej as mendjemadhe e as krenare. Shtëpia konsiderohej e paprekshme, kështu që ishte një vend i sigurt.

Mikpritja, konsiderohej e shenjtë. Sipas Kanunit, shtëpia e shqiptarit i përket Zotit dhe mikut. Mikpritja ishte, pra, një detyrim moral. Në çfarëdoqë momenti shtëpia e shqiptarit duhej të ishte e gatshme të priste mikun sipas formulës: *bukë*, *kripë* e *zemër*. Pranimi parashikonte bashkëndarjen e vaktit, mundësinë e një shtrati për natën dhe ngrohtësinë e zjarrit. Kryefamiljari i siguronte mikut mbrojtjen e vet pavarësisht se mund ta shtynte në situatë gjakmarrjeje. Për më tepër, edhe kur ky



i fundit do të rinisej për rrugë, i zoti i shtëpisë duhej ta shoqëronte, duke u siguruar që të ecte i pashqetësuar në rrugën e vet, deri aty ku do t'i ishte kërkuar. Ai që ofronte mikpritjen, ishte edhe, i detyruar të deklaronte gjakmarrjen kundër cilitdo që të kishte fyer ose plagosur vizitorin e tij.

Burrnija vjen nga *burrë*, domethënë, njeri i gjinisë mashkullore. Ky koncept identifikon burrrërinë, “të qenët burrë” që nënkupton të qenit person i virtutshëm dhe i denjë për nder, kushtuar fisit dhe familjes së tij. Kush nuk i respektonte premtimet e bëra, mikpritjen, marrëveshjet, armëpushimet dhe mbrojtjen e dhënë, konsiderohej *i shburrnuem* o *i zhburrnuar*, “i çnderuar” e “i turpëruar”. Gjakmarrja bëhej vetëm te burrat, ose mbi meshkujt që kishin mbushur 15 vjeç. Fëmijët nën 15 vjeç dhe femrat ishin të përjashtuara nga gjakmarrja.

Gjaku rregullonte marrëdhëniet brenda dhe jashtë fiseve. Për këtë arsye ai përbënte një element mbizotërues të strukturës sociale. Qëndrueshmëria e gjaku është tipike në shoqëritë në të cilat lidhjet familjare janë themelore. Në grindjet, gjaku i derdhur bëhej njësi matëse me të cilën gjakmarrja çohej përpara. Në komunitetin e rregulluar nga Kanuni, individët e gjinisë mashkullore konsideroheshin të barabartë. Barazia e burrave përcaktonte rregullimin e marrëdhënieve shoqërore, duke favorizuar zhdukjen, të paktën në princip të abuzimit nga ana e atyre që gëzonin një pozitë shoqërore të privilegjuar. Si pasojë, mekanizmi sipas të cilit *gjakmarrja* praktikohet në këtë supozim që parashikonte “një kokë për një kokë” ose “*gjak për gjak*”, si një variant *i jus* talionis.

Gjaku është edhe simbol i lindjes së një lidhjeje vëllazërie. Në fakt, përballë një çnderimi Kanuni nuk parashikonte vetëm mundësinë e zhvillimit të gjakmarrjes. Sipas kodit, ai që kishte pësuar dëmin mund edhe të vendoste të falte fisin që e kishte shkaktuar. Në Kanunin e Lek Dukagjinit lexohet: “çnderimi nuk merr hak me shpërbliim, por me derdhje gjaku ose me një falje fisnike⁶” (*falja*). Të falësh konsiderohej si *burmore*, pra një zgjedhje e ndershme e kurajoze. Potenciali paqtues i Kanunit është te *besa* dhe te pajtimi që bëhen përmes ndërmjetësimit. Ndërmjetësit janë figura të bashkësisë apo fetare që nëpërmjet autoritetit të tyre moral, drejtojnë ndërhyrjen e ndërmjetësisë duke ndikuar në pikëpamjet dhe në sjelljen e të dyja palëve në konflikt.

Kur fiset në konflikt vendosin të falin fyerjen e pësuar, në fund të procesit të ndërmjetësisë kremtohet një rit *pajtimi*. Në të kaluarën gjatë këtij riti, pjesëmarrësit pinin një pikë të gjakut të njëri-tjetrit të përzier me raki ose ujë, duke kryqëzuar krahët e tyre gjatë pirjes. Të pish reciprokisht një pikë gjaku do të thonte të hysh në lidhje familjare dhe të ruash këto lidhje edhe te pasardhësit.

Gjakmarrja, falja dhe pajtimi përbënin një sistem drejtësie që u përgjigjej nevojave për të rregulluar marrëdhëniet ndërmjet subjekteve dhe familjeve autoktone aty ku turqit nuk arritën të impononin një “autoritet” qeverisjeje. Në këtë lloj shoqërie, gjakmarrja çohej përpara nga pala e fyer si sanksion për atë që është vuajtur, me

6 Martucci, 2009, f. 154.



qëllim që të veprojë si pengesë për kryerjen e veprave kriminale. Në këtë kuptim gjakmarrja mund të konsiderohet një mjet i përdorur në të shkuarën për të mbajtur rendin publik shoqëror në një shoqëri pa pushtet shtetëror.

Gjatë periudhës së sundimit osman (shekulli XV-XIX), Kanuni është respektuar dhe zbatuar veçanërisht në zonat malore të vendit, duke përbërë trashëgiminë kulturore tradicionale të zonës. Të gjitha normat e kodit përfshirë edhe ato që lidhen me *gjakmarrjen*, janë zbatuar në forma të ndryshme sipas konteksteve shoqërore dhe rrethanave historike në të cilat zbatoheshin. Mund të dallojmë disa variante të kodit: Kanuni i Lek Dukagjinit⁷, Kanuni i Mirditës, Kanuni i Pukës, Kanuni i Lumës, Kanuni i Çermenikës, Kanuni i Bendës, të përdorur në zonën veriore; Kanuni i Labërisë në pjesën jugore; Kanuni i Skënderbeut⁸, i njohur edhe si Kanuni i Arbërisë, në zonën qendrore. Ky ligj kushtetues duhet të konsiderohet një element jo i ngurtë që iu nënshtrua ndryshimeve të vazhdueshme.

Në fillim të 900-ës, pavarësisht shtrëngimit të kontrollit të ushtruar nga Stambolli në zonën e veriut, bashkësitë e zonës vazhdonin të vetqeveriseshin sipas sistemit fisnor. Përkundrazi, politika e egër turke nxiti qëllimet ekzistuese të rebelimit dhe në 1912-ën Shqipëria arriti pavarësinë. Shteti i ri shqiptar filloi në vitet në vazhdim të miratonte ligje, një kod civil e penal dhe të një qeverisjeje qendrore që kundërshtonte organizimin e shoqërisë së maleve. Veçanërisht në zonën veriore të vendit, në mënyrë jozyrtare fiset nuk i pranuan ligjet e shtetit duke treguar një besnikëri të devotshme ndaj Kanunit. Gjakmarrja ishte e përhapur akoma në atë kohë sa mund të përfshinte gjithë komunitetin e fshatit. Vetëm gjatë pushtimit fashist italian (1939-1943), praktika e gjakmarrjes u dobësua. Prania italiane e kishte shtyrë popullsinë lokale të përqendrohej te rezistenca ndaj të huajit, duke kufizuar kështu gjakmarrjen në favor të proceseve të pajtimit të aftë për të korrigjuar konfliktet akoma të hapura. Nga 1946 deri 1991, Shqipëria u qeveris nga regjimi komunist, që u bë pak nga pak më totalitar, derisa u transformua në një diktaturë të vërtetë. Përmes qendërimit të pushtetit në duart e veta dhe në ata të Partisë së Punës sekretar i së cilës ishte, Enver Hoxha, qeverisi Shqipërinë për rreth dyzet vite, deri në vdekjen e tij në vitin 1985. Modernizimi i vendit u arrit nëpërmjet industrializimit e shtetëzimit të ndërmarrjeve private. Prona private u zhduk dhe u zëvendësua nga kolektivizimi i detyruar i tokave. Hoxha mori masa që ndalonin lirinë e besimit derisa imponoi në vitin 1967 të qenit ateist të shtetit. Politika e partisë së punës kishte si objektiv heqjen e vlerave tradicionale dhe zëvendësimin e tyre me ato të ideologjisë komuniste. Kodi

7 Lek III Dukagjini (1410-1481), princ pasardhës i një familjeje të pasur të zonës së Dukagjinit, të cilit i takon merita e mbledhjes, integritimit dhe kodifikimit në formë jo të shkruar të dispozitave gojore të praktikuar më parë nga popullsia e maleve të veriut të Shqipërisë.

8 Gjergj Kastrioti (1405-1468), i njohur si Skënderbeu, në vitin 1444 në Lezhë, bëri një aleancë ndërmjet gjithë princave dhe fisnikëve shqiptarë më të rëndësishëm, ndërmjet të cilëve ishte edhe Lek III Dukagjini, që solli formimin e një ushtrie të përhershme për të kundërshtuar pushtimin osman. Rezistenca ndaj pushtuesit osman zgjati rreth 25 vite, duke përfunduar me shkrirjen e aleancës dhe vdekjen e Skënderbeut (1468), që u bë më vonë hero kombëtar.



i maleve që karakterizonte prej shekujsh etikën e popullsisë së veriut të Shqipërisë, i pengonte nga një anë, konsolidimin e vlerave që promovonte modernizimi dhe nga ana tjetër rastet e padiskutueshmërisë dhe absolutizmit të ideologjisë së Hoxhës. Kanuni e njihte dhe e sanksiononte pronën private, gjë që ishte krejt e kundërt me atë që realizoi Partia e Punës, kolektivizimi i tokave. Kodi e kundërshtonte ateizmin e shtetit për sa kohë përmbante referenca të qarta në sferën kishtarë dhe fenë e krishterë. Politika e zbatuar nga Partia e Punës kishte qëllim të zhdukte moralin aktual në kod. Regjimi vuri dënime të rënda ndaj atyre që zbatonin Kanunin. Në periudhën e komunizmit, fenomeni i *gjakmarrjes* në territorin kombëtar u zvogëluu ndjeshëm. Edhe pse rastet e *gjakmarrjes* u kufizuan, parimet rregulluese të bashkësisë së fshatit në veri të Shqipërisë nuk u hoqën.

Pas rënies së regjimit komunist, vendi gjendej në kushte pasigurie. Investimet për një ripërtëritje ekonomike të vendit ishin të pamjaftueshme dhe shërbimet bazë nuk ishin të garantuara. Në vitin 1997 përpjekjet për rimëkëmbje ekonomike rezultuan një dështim dramatik. Skema e Ponzi u përdor nga qeveria për lejimin e formimit të firmave piramidale që patën një funksion të ngjashëm me bankat. Klientët e këtyre firmave ishin stimuluar për të investuar në ta kursimet e veta të gënjyer nga norma e lartë e interesit që do t'u lejonte atyre një rritje të shpejtë të të ardhurave. U krijua një fluskë financiare që në momentin e shpërthimit mori me vete të ardhurat e investitorëve. Niveli i varfërisë u bë akoma edhe më i lartë se më përpara dhe vendi përfundoi në falimentim. Si reagim ndaj kësaj, popullsia shqiptare sulmoi depozitat e armëve të shtetit për t'u përpjekur kështu të rimerrte atë që kishte humbur dhe kështu plasi lufta civile.

Situata e pasigurisë dhe mungesa e pushtetit, që u krijua pas rënies së komunizmit përcaktuan rishfaqjen e fenomenit që me shkatërrimin e vlerave të modernizimit, rizbulonte ato tradicionale. *Gjakmarrja* ringjallej në një kontekst që edhe një herë karakterizohej nga mungesa e autoritetit shtetëror. Nëse nga një anë gjakmarrja vazhdonte të kishte një rol "rregullues" të rendit publik, në mungesë të një sistemi drejtësie efikas, nga ana tjetër praktikimi i saj merre domethënie të reja. Gjakmarrja ishte më shumë një mjet për t'u përgjigjur konflikteve në veprim. Në një sistem krejtësisht të ndryshëm nga i cili lindi, ajo po shtremërohej. Si pasojë funksionimi i gjakmarrjes shkonte përtej detyrës së saj tradicionale. Ajo filloi të zbatohet në një mënyrë të shtrembëruar dhe instrumentale për situatën e kushtëzuar. Ndërmjet shkaqeve kontekstuale që përcaktuan shfaqjen e gjakmarrjes në formë degjeneruese, dallojmë:

- **disa elementë të trashëguar nga e kaluara e afërt e Shqipërisë.** Kur kooperativat bujqësore u shkrinë, filloi një luftë për rikthimin e pronës private. Toka u rishpërnda. Në veri të vendit privatizimi ndodhi me shumë vështirësi. Kolektivizimi kishte aritur me dhjetë e ndonjëherë edhe me njëzet vjet me vonesë krahasuar me jugun e Shqipërisë. Nga një anë, kujtimi i ndarjes së tokës para lindjes së kooperativave bujqësore ishte i pranishëm. Nga ana tjetër në vitet '90 toka iu dha falas fshatarëve në rolin e poseduesve dhe jo të pronarëve. Disa



familje u gjendën para aktit që duhet të jetonin në strukturat që ishin ngritur në pronat e dikujt tjetër. Kjo përcaktoi shpërthimin e konflikteve të ndryshme.

- **Boshllëqet institucionale.** Institucionet politike shqiptare u dorëzuan me vështirësi sepse kjo rrjedh nga trashëgimia e rëndë e regjimit. Në vitet '90, paqëndrueshmëria e shtetit dhe e ligjit shtetëror kanë prodhuar institucione delikate të karakterizuara nga një nivel i lartë korrupsioni në administrimin publik. Në veçanti, korrupsioni në gjyqësor ka qënë aspekt përcaktues i praktikës së hakmarrjes. Nëse anëtarët e fiseve më të fuqishme nga pikëpamja ekonomike dhe e prestigjit shoqëror mund të kishin një trajtim gjyqësor të ndryshëm nga të tjerët, atëherë ligji nuk ishte i barabartë për të gjithë. Mungesa e sigurisë së dënimit për atë që bënte krime të lidhura me nderin ose hakmarrjen solli, pra, pasiguri kolektive, duke vepruar kundrejt shtetit. Gjakmarrja u bë në shumë raste sinonim i drejtësisë private kur ajo shtetërore nuk e bënte detyrën e saj. Përveç kësaj, korrupsioni shkaktoi një problematikë tjetër. Parimet demokratike që u nënshtrohen ligjeve të shtetit u boshatisën në momentin kur vetë ligjet nuk gjenin zbatim apo zbatoheshin *ad personam*. Bashkësitë mund të mos i njohin vlerat e demokratizimit, nëse në praktikë përkthehen në korrupsion. Megjithatë, nevoja sociale për të caktuar vlera mbetet dhe për këtë janë kthyer në parimet mbizotëruese të së shkuarës. Nëse ligji nuk është i barabartë për të gjithë, autoktonët mund të preferojnë të legjitimizojnë ligjin e shpagimit, derisa ai duket se garanton një trajtim të barabartë për të gjithë. Në këtë mënyrë, shkuarja drejt një vetëgjyqësie i dha fillësë një sistemi gjyqësor paralel me atë shtetëror.
- **Niveli i ulët i arsimimit** ka sjellë formimin e një edukimi të papërshtatshëm e të pamjaftueshëm ndaj respektit të rregullave demokratike, veçanërisht në grumbullimet e reja periferike. Këto grumbullime të reja individësh gjenden në një situatë ku nuk janë të zbatueshme rregullat e kontrollit shoqëror të vlefshme në zonat tradicionale nga vijnë dhe kanë vështirësi në përshtatjen e shpejtë ndaj rregullave të shtetit në ecje drejt një pohimi të plotë të demokracisë. Përveç kësaj, në bazë të një hetimi të Avokatit të Popullit që lidhet me studimin e vrasjeve të bëra për arsye hakmarrjeje nga 1990 deri 2012, rezultoi që 39% e këtyre krimeve janë bërë nga autorë që kishin një nivel të ulët arsimimi ose mungonin fare⁹.
- **Shkaqe demografike,** lidhur me migrimin e brendshëm që në vitet '90 ka karakterizuar zhvendosjen e popullsisë shqiptare nga zonat malore në ato urbane e periferike. Në këtë mënyrë është gjeneruar përhapja e mentalitetit tradicional tipik të maleve.
- **Elemente kulturore që karakterizojnë kontekstin social aktual.** Në vitet '90 zhvillimi i dobët ekonomik, migrimi i brendshëm nga zonat malore në ato periferike, niveli i ulët i arsimimit të zonave rurale kanë krijuar në raste të ndryshme kushtet për mbajtjen e një kulture të përqendruar të familjarizimit, patriarkalizmit dhe maskilizmit. Përveç kësaj, në disa zona të Shqipërisë mentaliteti tradicional

9 Resuli E. (03.04.2013), Gjakmarrja, 6 mije te vrare dhe 10 mije te ngjuar, *Shekulli*, Tirana.



është ruajtur edhe nëpërmjet martesave mblesëri, në të cilat bashkëshortët kanë origjinë malore. Në këtë mënyrë, janë prodhuar disa sjellje të lidhura me një kulturë fisnore: familja është bërthama themeluese e bashkësisë patriarkale dhe me të lidhjet e gjakut, liria e vendosmërisë personale është e lidhur më atë të familjes, jeta nuk është gjithmonë vlera shoqërore më e rëndësishme, shprehja e personalitetit personal është e lidhur me rolin tradicional që secili ka brenda sferës familjare, presioni shoqëror përcakton sjelljen e personave dhe fiseve respektive të cilëve u përkasin.

- **Shkaqe gjeografike**, lidhur me izolimin që akoma sot karakterizon disa zona. Papërshkueshmëria e disa prej pjesëve të territorit malor kanë shkaktuar mbajtjen e kushteve të jetës së vështirë në malet e veriut të Shqipërisë dhe të kujtimit të traditës, duke promovuar një farë rezistence ndaj asimilimit të ideve të tjera. Nga pikëpamja e brendshme, praktika e hakmarrjeve paraqet një nga kontradiktat e një shoqërie që nuk është as plotësisht moderne e as tradicionale që është ajo e Shqipërisë bashkëkohore. Ajo konsumohet në një kontekst ku ndërgjegja civile dhe politike është në rrugë formimi, lëvizjet shoqërore në mbrojtje të të drejtave të caktuara janë akoma të copëzuara dhe përfshirja e edukimit me të drejtat njerëzore në sistemet shkollore parësore e dytësore është e nevojshme. Nga pikëpamja e jashtme, përdorimi i hakmarrjes dhe gjakmarrjes përbën një pengesë për hyrjen e vendit në Bashkimin Evropian sepse përbën shkeljen e të drejtave themelore të njeriut. Ndër kushtet e vëna nga BE për hyrjen e Shqipërisë në Evropë gjejmë në fakt eliminimin e fenomenit. Sipas standardeve evropiane nuk mund të ekzistojnë sisteme drejtësie private. Përveç kësaj, përdorimi i hakmarrjes dhe gjakmarrjes përfshin probleme të rendit publik jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në nivel ndërkombëtar, meqenëse disa raste të *gjakmarrjes* e *hakmarrjes* janë konsumuar edhe jashtë kufijve shtetërorë (Par. 3).

2. KARAKTERISTIKA, DINAMIKA E PASOJA TË FENOMENIT¹⁰

Në njëzet vitet e fundit, apelimi ndaj traditës zakonore i është përgjigjur disa nevojave diktuar nga konteksti i ri në të cilin manifestohet. Nga njëra anë mund të identifikohet nevoja e përmbushjes së boshllëqeve institucionale të pranishme dhe të luftohet mosbesimi pasues që rrjedh prej saj, nga ana tjetër urgjenca e përballjes së ardhjes së një modeli të ri si kapitalizmi global dhe vlerat që e përfaqësojnë. Përveç kësaj, migrimi i brendshëm nga zonat malore në lagjet periferike të qyteteve e ka vënë çështjen në vështirësi drejtimin e këtyre flukseve dhe të rrënjosjes së tyre në zonat

¹⁰ Rastet e hakmarrjes dhe gjakmarrjes të sjella në këtë paragraf kanë ndodhur në vitet e fundit dhe citohen për të treguar një farë vazhdimi të fenomenit.



urbane e periferike. Siç kemi parë, background-i i banorëve të bashkësive malore përbëhej akoma nga kujtimi i traditës së Kanunit. Kjo trashëgimi mund të ketë plotësuar nevojën e popullsisë malore për të mbajtur një identitet kur migrimi drejt vendeve në të cilat procesi i integritimit ishte i vështirë, i vinte në provë të vështirë ekzistencën. Për këtë, aktualisht mund të gjejmë nevoja të popullsisë që për disa raste, rezultojnë të ngjashme në të shkuarën e në të tashmen, por, meqenëse u përkasin konteksteve krejt të ndryshme shfaqen në forma të ndryshme. Në këtë kuptim, sot format tradicionale zbatohen në mënyrë të ndryshme nga ata të shkruara në kodin e Kanunit të Lek Dukagjinit, duke u dhënë jetë fenomeneve për shumë aspekte të reja. *Gjakmarrja* është një shembull. Hakmarrja nuk është e lidhur më me praktikën tradicionale që vjen nga kodi. Ajo është transformuar në një fenomen kompleks. Kujtimi i Kanunit pëson ndryshime konstante në praktikë edhe pse shumë prej familjeve në grindje nuk kanë njohje të drejtpërdrejtë të kodit. Nga pikëpamja kulturore, në fakt, fenomeni, nisët nga tradita fillestare dhe në të njëjtën kohë, risjell disa aspekte që duke qenë se janë fryt i konteksteve të reja nuk janë më të kapshëm në fushën e zakonit, sepse sjellin domethënie të reja socio-kulturore të vetë fenomenit.

Më poshtë do të citohen disa raste që ato tregojnë keqpërdorimin e zakonit në praktikën e gjakmarrjes.

Së pari, sipas versionit më të vjetër të kodit të maleve shqiptare, vetëm vrasësi binte në gjakmarrje. Këto predispozita janë modifikuar në kohë. Në pjesën më të madhe të grindjeve që çojnë në raste gjakmarrjeje, rrallë goditet ekzekutuesi i një vrasjeje, ndërsa më shpesh ndodh që janë të afërmit meshkuj të këtij të fundit që vihen në shënjestër.

Së dyti, në bazë të Kanunit të Lek Dukagjinit figurat fetare, gratë e fëmijët nën 15 vjeç janë të përjashtuar nga *gjakmarrja*. Në vitet e fundit janë regjistruar raste në të cilat gra, fëmijë e përfaqësues të klerit kanë qenë viktimë të dhunës së shkaktuar nga gjakmarrja. 8 tetorin e 2010-ës, është vrarë një pastor protestant për shkaqe që lidhen me një histori hakmarrjeje në të cilën një degë e familjes së tij ishte përfshirë. Në Dukagjin, në qershor 2012, u regjistrua vrasja e një vajze 17 vjeçe për shkak të një grindjeje ndërmjet fisit të familjes së saj të origjinës dhe një fisi tjetër (Shqip, 15.06.2012; Shqip, 20.06.2012; Shekulli, Panorama, Gazeta Shqiptare, 16.06.2012; Gazeta Shqiptare, 19.06.2012). Në prill 2013, një vajzë 18 vjeçe është vrarë në një fshat të maleve të Tropojës gjatë një konflikti pronësie ndërmjet të atit dhe kushëririt të tij (Gazeta Shqiptare, Panorama, 27.04.2013).

Në Kanunin e Lek Dukagjinit lexohet që vrasja e pavullnetshme nuk duhet të hakmerret me armë. Në vitet e fundit ka pasur raste në të cilat gjakmarrja është bërë mbi persona që janë gjendur “në vendin e gabuar, në momentin e gabuar”. Shembull është vrasja e Endri Llani, 9 vjeç, e ndodhur më 5 maj 2012 në Mamurras. Viktima u godit “gabimisht” nga një plumb i destinuar për xhaxhanë e tij, një djalë 22 vjeçar, për një grindje me një person. Pas rreth dhjetë muajsh i ati i fëmijës është hakmarrë duke vrarë një burrë 71 vjeç, i dyshimtë për vrasjen e të voglit (Shqip, Gazeta Shqiptare, 06.06.2012).



Së treti, përgjithësisht kanë qenë anëtarët më të vjetër të fisit ose të familjeve të përfshira në grindje për të vendosur mënyrën e sjelljes që vetë fisi duhet të kishte mbajtur kundrejt palës tjetër, por aktualisht vendimi për t'u hakmarrë mund të merret edhe nga anëtarët e rinj meshkuj të familjes.

Përveç kësaj, abuzimi i Kanunit ka sjellë degjenerimin e praktikës së vetmbylles, (*ngujimi*¹¹) nga ana e vrasësit brenda banesës së tij. Sipas Kanunit të Lek Dukagjinit, *ngujimi* parashikohej edhe për të afërmit e vrasësit vetëm kur familja e viktimës nuk kishte dhënë besën familjes së fajtorit. Në ditët e sotme, fenomeni i ngujimit përfshin shpesh edhe të afërmit e vrasësit. Anëtarët e fisit të vrasësit kanë tendencë të zhvendosen nga vendi ku ka ndodhur vrasja, duke u transferuar në një zonë tjetër, edhe jashtë shtetit. Ky veprim, nuk është megjithatë, gjithmonë efikas për të ulur nivelin e tensionit ndërmjet palëve ose të garantojë sigurinë e subjekteve të përfshira. Kërcënimet e drejtpërdrejta apo jo, reale apo të detyruara nga frika që mund të pësojnë hakmarrje, i shtojnë pjesëtarët e fisit që është njollosur me krim të mbyllën në shtëpi dhe të jetojnë në një klimë dyshimi. Zakonisht familjet që rrezikojnë të pësojnë hakmarrje, përfundojnë të jetojnë në një gjendje izolimi nga bota e jashtme. Ka nga ata që gjenden në këtë situatë ngujimi, duke humbur punën dhe mundësinë e përmbushjes së nevojave të familjes. Në vitet e fundit janë regjistruar raste në të cilat edhe fëmijët meshkuj e femra, vajza e gra, që kanë lidhje gjaku me vrasësin janë “gozhduar” në shtëpitë e tyre. Aktualisht, fenomeni i gjakmarrjes identifikohet shpesh nga opinioni publik shqiptar me praktikën e ngujimit, edhe pse ky interpretim nuk favorizon kuptimin e heterogjenitetit dhe të shtrirjes së fenomenit.

Nga abuzimi i zakonit lind mentaliteti nga i cili dalin dhe përkeqësojnë konfliktet aktuale. Konfliktet e lidhura me fenomenin e gjakmarrjes janë klasifikuar si mikrokonflikte të cilat mbas përfshirjes së mëvonshme edhe të të afërmeve të subjekteve në mosmarrëveshje, degjenerojnë në mesokonflikte. Konflikte që fillimisht përfshijnë pak individë, përfundojnë pastaj t'u interesojnë familjeve të subjekteve të goditura. Përfshirja e familjeve mund të përfshijë të gjithë fisin të cilit i përket. Në fakt, për shkak të traditës nga e cila vjen fenomeni, praktika është akoma e lidhur fort me konceptet e gjakut dhe të nderit. Lidhja e gjakut përcakton lidhjet e afri së mbi të cilat krijohet familja dhe secili anëtar që e përbën. Sipas zakonit, lidhja e gjakut transmetohet vetëm në linjë mashkullore, dhe, edhe pse aktet e ndershme dhe të turpshme mund t'u përkasin si burrave ashtu edhe grave, do t'u takonte të parëve t'i përmbushin ato në përputhje me vendimet e familjes.

Deri tani hakmarrja godet mbi të gjitha subjekte të gjinisë mashkullore. Nderi është element rregullues i marrëdhënieve shoqërore. Ky aspekt përkon me respektimin që personi arrin të fitojë ndaj shoqërisë, nëpërmjet veprimeve të ndershme. Peshë e këtyre të fundit bie drejtpërdrejt mbi respektimin e familjes me të cilën personi është i lidhur nga gjaku. Në këtë mënyrë, familja dhe fisi në të cilin bën pjesë, marrin nder. Këto parime mund të përcaktojnë qëndrimet dhe sjelljet e subjekteve

11 Fjalë për fjalë do të thotë “gozhdim”.

dhe familjeve që u përkasin. Rivendosja e nderit mund të konsiderohet një detyrë e domosdoshme për t'u trajtuar me respekt nga bashkësia.

Pjesa më e madhe e rasteve të lidhura me fenomenin e gjakmarrjes shfaqen në vende në të cilat kushtet e jetës së popullsisë janë më të pasigurta. Zonat më të goditura nga fenomeni janë ato periferike e malore ku papunësia, niveli i varfërisë, mungesa e shërbimeve bazë publike dhe disa qëndrime sociale të tilla si patriarkalizmi dhe maskilizmi janë të forta. Por mentaliteti që karakterizon grindjet nuk është tipik vetëm i vendeve të izoluara. Meqë një pjesë e mirë e banorëve të qytetit vijnë nga zonat rurale, nuk është e lehtë të gjesh një shqiptar që është me origjinë nga qytetet e mëdha të vendit. *Melting pot* shqiptar ka prodhuar, pra, një përzierje të mentaliteteve të ndryshme, kështu që sot duket e komplikuar të arrish të përjashtosh krejtësisht ekzistencën e logjikave të lidhura me Kanunin edhe në zonat urbane. Përveç kësaj, për shkak të origjinës së krishterë të kodit, fenomeni i gjakmarrjes godet më shumë familjet me origjinë të krishterë. Në fakt, veriu i vendit vazhdon të jetë zona gjeografike në të cilën fenomeni është më i rrënjosur sepse në këtë zonë përqendrohet edhe pjesa më e madhe e të krishterëve katolikë të vendit. Përveç kësaj, duhet të pranojmë edhe karakterin "transfetar" të praktikës së hakmarrjes. Praktika e hakmarrjes mund të përfshijë çfarëdo familjeje shqiptare. Për këtë ajo, ikën nga feja, por në të njëjtën kohë prek të gjitha besimet e pranishme në territorin e vendit. Fenomeni shprehet nëpërmjet dy mënyrave vepruese që ekzistojnë në të shkuarën, hakmarrja dhe gjakmarrja, por që, për shkak të abuzimit të traditës, shfaqen në të tashmen me dinamika të tjetërsuara krahasuar me ato të origjinës. Edhe pse viktimat e fenomenit vazhdojnë të përdorin këto përcaktime, duke u bazuar akoma në vlerën simbolike të referencës, disa studiues pyesin nëse është e pavend të vazhdojmë të përcaktojmë me këto terma praktikën e sotme të gjakmarrjes, që janë shumë larg nga zbatimi i tyre fillestar. Për të qartësuar këto dinamika, tipike të konflikteve të fenomenit të gjakmarrjes do të sillen disa shembuj.

RASTE TË GJAKMARRJES:

1. Më 14 shkurt 2013 në një fshat në rrethinat e Peshkopisë, Hike Skuka, gruaja e Uran Skuka, e Xhemile Skuka, gruaja e Edmond Skuka (Uran e Edmond janë vëllezër), vrasin gjashtëdhjetëvjeçaren Naime Skuka (nëna e Uran e Edmond Skuka), për shkak të abuzimeve të pësuar nga kjo e fundit, duke i hedhur vaj të nxehtë në vesh. Më 13 shkurt 2014, Uran Skuka vret Basri Nikollin, vëllanë e ish-gruas së tij, për të hakmarrë vrasjen e nënës (Gazeta Shqiptare, 20.07.2014; Panorama, Gazeta Shqiptare, Shekulli, 10.08.2014). Në vitin 2014 Uran Skuka dënohet me 35 vjet burg me akuzën e vrasjes për gjakmarrje dhe mbajtje armësh zjarri pa leje (Panorama, 7.10.2014).

FISI NIKOLLI VS. FISI SKUKA

Hike Skuka (ish-fisi Nikolli) e Xhamile Skuka ----- vrasin për hakmarrje -----> Naime Skuka, nënën e Uran e Edmond, bashkëshortët respektivë të Hike e Xhamile



PAS NJË VITI

Uran Skuka ---- vret për *gjakmarrje* -----> Basri Nikolli, vëllanë e ish-gruas Hike

2. Në vitin 1991, Lulzim Shera kishte vrarë për një grindje shokun e qelisë Arjan Baku, ndërsa po vuante dënimin për nxitje për vetëvrasje kundrejt një vajzë. Pas vrasjes, dënimi iu shtua me 20 vjet. Më 1 shtator 2013, pas më shumë se një viti nga dalja prej burgut dhe mbi 20 vjet nga koha e vrasjes, Altin e Skënder Baku, vëllezër të Arjanit, bëjnë gjakmarrjen¹², duke e vrarë në Fushë-Krujë dyzetvjeçarin Lulzim Shera, vrasësin e vëllait, edhe pse kishte vuajtur dënimin me burg 20 vjet.

FISI SHERA VS. FISI BAKU

Lulzim Shera ----- vret për *hakmarrje* -----> Arjan Baku, vëllain e Altin e Skënder Baku

PAS 22 VITESH

Altin Baku, Skënder Baku ---- vrasin për *gjakmarrje* -----> Lulzim Shera

Gjakmarrja mund të cojë në lindjen e cikleve të hakmarrjeve që vrasin pak nga pak anëtarët e familjeve, duke vënë në rrezik jetën e të gjithë atyre që kanë lidhje gjaku me atë që ka fyer nderin e palës tjetër. Situatat e gjakmarrjes janë pra, mosmarrëveshje që nuk zgjidhen lehtë. Rasti i fundit (fisi Shera vs. fisi Baku) vë në dukje, për shembull se si siguria e dënimit nuk është gjithmonë një kusht i mjaftueshëm për të garantuar që gjakmarrja nuk do të bëhet. Meqë fenomeni është fryt i një mentaliteti të caktuar, është e nevojshme të kundërshtohet, jo vetëm në planin e reformave, për të rivendosur organet e drejtësisë, por edhe në planin kulturor (Par. 1).

RASTE TË HAKMARRJES

1. Më 11 korrik 2015, Abaz Isa, 54 vjeç, ka vrarë bariun Marjo Laho, 26 vjeç, në malet e Gramozit për një konflikt që dukej i lidhur pronësinë e kullotave, por që më vonë është kthyer në rrahje të shkaktuara nga Marjo Laho ndaj Abaz Isës, pasi ky i fundit kishte rrahur më parë babain e viktimës (Panorama, Shekulli, Gazeta Shqiptare, 13.07.2015; Gazeta Shqiptare, Panorama, Shekulli, 15.07.2015; Shekulli, Shqip, 20.07.2015).

FISI LAHO VS. FISI ISA

Abaz Isa ----- vret për *hakmarrje* -----> Marjo Laho

2. Tom Lala, 69 vjeç, ka vrarë Mark Ndreca, kushëririn e tij 50 vjeç, në një fshat të Kurbinut, më 2 prill 2016 për shkak të një konflikti mbi pronën. Pak pas vrazes, familja e vrasësit është ngjuar në shtëpi për shkak të frikës që mund të konsumohej gjakmarrja kundrejt saj. Për parandalimin e kësaj, policia monitoroi zonën për disa

¹² <http://shekulli.com.al/29800/>.

ditë (Gazeta Shqiptare, Panorama, 3.04.16; Panorama, 4.04.16, 5.04.16, 6.04.16; Gazeta Shqiptare, Panorama, 07.04.16; Gazeta Shqiptare, 09.04.16; Panorama, 10.04.2016; Panorama, Gazeta Shqiptare, 24.06.2016).

FISI NDRECA VS. FISI LALA

Tom Lala -----vret për *hakmarrje* -----> Mark Ndreca

Situatat e hakmarrjes mund të degjenerojnë në zbatimin e hakmarrjes duke u transformuar kështu në mosmarrëveshje. Shkaqet kryesore të konflikteve që si pasojë e fenomenit të gjakmarrjes janë:

- *çështje pronësie*. Faktorët historikë, ose më mirë proceset dhe ngjarjet e së kaluarës që kanë përcaktuar shpërndarjen aktuale të tokave në bashkësi, janë kyç në rihapjen e disa konteksteve (Par. 1). Më 12 gusht 2015, në një fshat të zonës së Kukësit, gjasht burra që u përkisnin fiseve të ndryshme pothuajse janë vrarë mes tyre për një grindje mbi pronësinë e një kanali uji (Gazeta Shqiptare, Panorama, 13.08.2015).
- *Trafiku i qenieve njerëzore*. Praktika e tregimit të qenieve njerëzore u përket para së gjithash individëve të gjinisë femërore në fushën e prostitucionit. Në këto raste, krimi i organizuar përdor Kanunin për të ligjëruar pozicionin dhe nënshttrimin e gruas. Në raste të tjera, kodi përdoret për të mbajtur rregullin e brendshëm, në kurriz të aspekteve pozitive të traditës, si pajtimi dhe mikpritja. Hakmarrja, pra, përdoret nga krimi i organizuar si formë e larjes së hesapeve në trafiket e paligjshme, si për shembull, kontrabanda.
- *Çështje nderi*, me të cilat lidhen mosmarrëveshjet e lindura për motive të dobëta. Në korrik 2015, në Greqi, është torturuar dhe vrarë një i ri 21 vjeçar, kufoma e të cilit është djegur pastaj nga një burrë xheloz që dyshonte një lidhje mes tij dhe gruas së tij. Të gjithë të përfshirët janë shqiptarë. Me çështjet e nderit lidhen edhe disa motive të dobëta si provokimet fizike dhe verbale, zillitë dhe xhelozitë, grindjet në bar për një gotë raki më shumë. Më 11 maj 2015, kryetari e një pjese të bashkisë Has, në zonën e Kukësit, ka qëlluar dy persona pas një konflikti për motive të dobëta, të përkeqësuar nga “një gotë tepër” (Gazeta Shqiptare, Shqip, 12.05.2015).
- *Aksidente me makinë*. Më 23 gusht 2012, një burrë është plagosur me armë zjarri kur ishte në makinë me të fejuarën e tij. Hetimet e policisë kanë supozuar që fakti mund të jetë akt hakmarrjeje i lidhur me një aksident me makinë që kishte ndodhur përpara në të cilin viktimi vrau një polic rrugor (Panorama, 19.11.2012).
- *Probleme me borxhe*. Më 11 gusht 2015 në një komunë të vogël të Tiranës, një i ri 19 vjeç, ka plagosur rëndë një djalë 27 vjeç për shkak të një borxhi prej 100 eurosh (Panorama, 15.08.2015).
- *Çështje pune*. Më 4 tetor 2013, një burrë 47 vjeç nga Shkodra është vrarë për çështje pune. Të dyshuarit kryesorë ishin kolegët e tij (Panorama, Shqip, 4.10.2013).



- *Frika e pësimit të një hakmarrje*, për një fyerje të bërë që i shtyn autorët e saj të godasin të parët. Në këto raste paaftësia e kontrollit të vetë emocioneve mund të shkojë në vrasje.

Ndër elementët që ndikojnë më shumë në vendimin e të çuarit përpara të hakmarrjes gjëjmë: paaftësi e kontrollit konstruktiv të emocioneve dhe presioni shoqëror.

Aspekti i parë shfaqet në rastet në të cilat ndjenja të tilla si zemërimi dhe pakënaqësia, përcaktojnë reagimet që çojnë në vrasje. Me kalimin e kohës këto ndjenja mund të shndërrohen në urrejtje dhe të përkthehen në përmbushjen e një hakmarrjeje. Aspekti i dytë i fenomenit është i përcaktuar nga ndikimi që konteksti shoqëror, brenda të cilit familja e viktimës së fenomenit është pjesë (komshinj, të afërm, shokë shkolle ose pune, etj.), ndikon mbi vendimet e fisit. Meqë, në kontekstin kulturor aktual hakmarrja praktikohet më shumë se sa falja dhe pajtimi– mundësitë e parashikuara nga tradita zakonore– presioni shoqëror rezulton që është negativ derisa mund të kushtëzojë zgjedhjen e hakmarrjes. Mund të ndodhë edhe, pas çnderimit të pësuar, që janë të afërmit më të largët ose që jetojnë jashtë shtetit, domethënë ata që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në zi, por që ndiejnë humbje të nderit familjar të ndikojnë negativisht mbi vendimet e viktimave. Kur ai që është goditur drejtpërsëdrejti nga fenomeni jeton në një kontekst që e stimulon të përdorë vuajtjen e provuara për të kultivuar urrejtje e mlllef, dëshira e hakmarrjes mund të ushqehet deri në përmbushjen e saj. Përshkallëzimi i konflikteve i transformon këto raste në spirale hakmarrjeje që ndikojnë dinamikat me të cilat mosmarrëveshjet shfaqen. Aspekte kryesore që përcaktojnë këto dinamika mund të jenë:

1. Për sa u përket **mënyrave me të cilat praktikohet hakmarrja**, veprat e bëra nga njëra anë dhe nga tjetra mund të bëhen gjithnjë e më brutale. Zakonisht, mënyrat me të cilat bëhet hakmarrja dhe efektet e saj nuk maten me çnderimin e pësuar. Dokumentaristja Basso përshkruan një nga konfliktet me të cilin është përplasur gjatë xhirimeve të “Kanun, il sangue e l’onore”¹³. Në një rast, konflikti i ka plasur në një kafene kur një grup miqsh kanë filluar të grinden. Në një moment zemërimi, një nga të pranishmit ka nxjerrë pistoletën dhe ka vrarë një tjetër. Përveç kësaj, të bësh *gjakmarrje*, kur pala kundërshtarë është duke festuar momente gëzimi si martesë apo pagëzime, do të thotë të prishësh lumturinë e familjes kundërshtarë dhe pra të shkaktojë një dëm emocional më të madh krahasuar me momentin kur hakmarrja bëhet në rrethana të zakonshme.

2. Intensifikimi i armiqësive provokon **përfshirjen gjithnjë e më të madhe të vepruesve**. Janë verifikuar raste në të cilat vrasësi ka goditur më shumë viktime se sa ka parashikuar, gjatë përmbushjes së hakmarrjes. Në vitin 2012, një djalë minore ka provuar të hakmerret për vrasjen e një të afërmi, por shpërthimi i të shtënave vetëm e ka plagosur shënjestren e tij dhe ka shkaktuar përfshirjen e dy viktimave të rastësishme: një djalë, i plagosur dhe një i ri që u vra (Gazeta Shqiptare, Shekulli, 23.11.2012; Gazeta Shqiptare, Shqip, Koha Jone, Panorama, 21.11.2012;

13 Basso, 2011 (Kanuni, gjaku e nderi).



Panorama, 22.11.2012). Pra, ka lindur një mosmarrëveshje e re ndërmjet familjes së minorenit dhe asaj të djalit të vrarë.

3. Shembujt e gjakmarrjes e hakmarrjes të sjella tregojnë se si përmbushja e hakmarrjes mund të ketë **kohë** shumë të ndryshme. Ajo mund të shpërthejë në shumë pak kohë ose mund të veprojë në distancë të disa viteve nga gabimi ose vrasja e parë e pësuar. Edhe pse historitë e lidhura me konflikte tejçohen në kohë, mund edhe të harrohet shkakun pse kanë filluar.

4. Nga njëra anë, kur **institucionet hasin vështirësi në zbatimin e ligjit në fuqi**, praktika e hakmarrjes përdoret si formë drejtësie private (Par. 1). Nga ana tjetër, përvetësimi i konceptit “publik” nga ana e popullit shqiptar nuk është realizuar akoma plotësisht. Pra, ndjekja e interesave private nga qytetarët shpesh është bartur përpara edhe në mënyrë të paligjshme. Këto aspekte favorizojnë përdorimin e sotëm të traditës së Kanunit.

5. **Qëndrimi pak bashkëpunues dhe konspirativ** nga ana e popullsisë lokale nuk ua lehtëson forcave policore hetimet. Konspiracioni për interes ose akoma më shpesh, nga frika që mund të pësojnë hakmarrje, ngadalëson rrugën e drejtësisë dhe pengon denoncimin e fakteve që lidhen me hakmarrjet.

Për të përshkruar efektet dhe pasojat e fenomenit, është e nevojshme të konsiderojmë që fenomeni kushtëzon plotësisht ekzistencën e atij që është i përfshirë. Niveli i pasigurisë dhe ndjenja e pasigurisë së jetës rriten jo vetëm për subjektet e përfshira, por edhe për shoqërinë shqiptare. Rastësia me të cilën ndodhin disa raste të hakmarrjes e të gjakmarrjes, mund të na lërë të presupozojmë që ka mundësi që të gjithë mund të goditen. Fenomeni shkon të prekë edhe sferën emotive të individëve dhe të bërthamave familjare. Pjesëtarët e familjeve që kanë lidhje gjaku me atë që ka bërë vrasje kanë frikë që mund të kërcënohen apo të vriten. Ngujimi shkakton ndjenja frustrimi dhe depresioni, duke ndikuar personalitetin e individëve të përfshirë. Që nga momenti në të cilin familja “bie në gjak” me një tjetër, përditshmëria e çdo pjesëtari të përfshirë ndërpritet dhe përcaktohet nga dinamikat e hakmarrjes. Në disa raste, të rinjtë dhe fëmijët mbahen në shtëpi nga prindërit dhe nuk çohen në shkollë, nga frika se mund t’u ndodhë diçka e keqe. Meshkujt që në moshë shumë të vogël konsiderohen dhe trajtohen si burrat e vegjël të shtëpisë. Etapat e fëmijërisë, që sjellin një rritje të ekuilibruar, digjen. Fenomeni ndikon, prandaj, aspektet që i përkasin formimit dhe rritjes së individëve, si edhe në fushën relacionale e sociale të jetës kolektive. Burrat që shkonin të punonin, i ndërpresin aktivitetet e tyre dhe mbyllën në shtëpitë e tyre. Situata e ngujimit sjell shpesh probleme alkolizmi tek burrat, duke shtuar kështu nivelin e dhunës familjare. Gratë mbajnë peshën e këtyre situatave sepse mund t’u takojë atyre drejtimi i shtëpisë, edukimi i fëmijëve dhe mbajtja ekonomike e familjes. Në fund, familjet që kanë pësuar një zi për shak të fenomenit të gjakmarrjes ndiejnë zemërim. Zemërimi, mund edhe të rritet nëse siguria e dënimit kundrejt vrasësit nuk është. Menaxhimi shkatërrues i kësaj ndjenje e transformon në mllef e pastaj në urrejtje. Urrëjtja



mund t' u transmetohet të gjithë anëtarëve të fisit të viktimës: të rinj, të rritur e të moshuar.

Tregimet e ngjarjes së ndodhur mund të përsëriten në mënyrë të tillë që të mbajnë gjallë kujtimin e fyerjes së pësuar. Këta elementë mund të ndikojnë vendimin për ta çuar përpara hakmarrjen. Vështirësitë më të përhapura janë: dëmet psikologjike (p.sh ndjenja e persekutimit, simptoma depresive, nervozizëm, alkolicizëm etj. që shpesh përkthehen në dhunë familjare) të prodhuara nga konteksti i dyshimit, mbylljes, frikës, vdekjes dhe dhunës në të cilat individët e përfshirë jetojnë e rriten; dëme fizike të shkaktuara nga mungesa e lirisë së lëvizjes, pra, në pamundësi për të pasur akses në kura mjekësore ose nga pasojat e veprimeve të dhunshme; rritja e analfabetizmit; dëmet ekonomike për shkak të papunësisë; propagandimi i situatave të konfliktit dhe të dhunës si shkak i kontekstit të përjashtimit dhe izolimit. Fenomeni i gjakmarrjes sjell, pra, shkelje të rënda të të drejtave themelore të njeriut. Ndër më të rëndësishmet dallojmë:

- e drejta e barazisë sepse shpesh ai që përfshihet në një mosmarrëveshje përjashtohet nga shoqëria;
- e drejta e jetës, e lirisë dhe sigurisë që shkelet nga përdorimi i hakmarrjes, gjakmarrjes e ngujimit;
- barazia përpara ligjit që shkelet kur siguria e dënimit nuk garantohet;
- respektimi i privatësisë, që shkelet sa herë që autoritetet dhe mas media përdorin keq të dhënat personale të subjekteve të përfshira në fenomen;
- e drejta për punë dhe e drejta për arsimim sepse shpesh ai që përfshihet në mosmarrëveshje shihet i përjashtuar ndaj aksesit edukativ e profesional;
- e drejta për azil. Kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare jashtë shtetit janë të motivuara nga hakmarrja, dhuna familjare, diskriminimi ndaj minoriteteve, trafikun i qenieve njerëzore dhe nga probleme ekonomike e shëndetësore. Sipas të dhënave të OSBE (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë) të vitit 2014, 43% dhe 40% e kërkesave për azil në Belgjikë e Francë janë të lidhura me hakmarrjen dhe gjakmarrjen. Jo gjithmonë është e lehtë të përcaktosh vërtetësinë e situatave të hakmarrjes ose gjakmarrjes në të cilat gjenden kërkuarit e azilit. Në disa raste, nevoja që të emigrojnë nga Shqipëria për probleme hakmarrjeje ose gjakmarrjeje është e vërtetë, por meqë faktet e gjakut nuk janë denoncuar apo regjistruar kërkesat mund të mos pranohen për mangësi provash. Në raste të tjera, nevoja e braktisjes së vendit diktohet nga pasiguria e kushteve të jetës që maskohen nga kërkuarit e azilit duke prezantuar certifikata fallso mbi situatën e rreme të hakmarrjes me qëllim që të ketë mundësi më të mëdha për të marrë azilin. Këto fakte kanë shtrënguar procedurat evropiane të parashikuara për të dhënë mbrojtje ndërkombëtare, në dëm të atyre që gjenden me të vërtetë në situatë hakmarrjeje ose gjakmarrjeje.

Fenomeni rezulton që është heterogjen dhe në evolucion të vazhdueshëm sepse niset nga tradita. Për këtë, rezulton që është një fenomen hibrid. Përveç kësaj, hibridizimi nënkupton përfshirjen e vendeve të ndryshme si për shembull, fshatrat dhe



qyetet. Në këtë kuptim, hibridizimi karakterizohet nga një raport pushteti ndërmjet qendrës dhe periferisë që mund të rrjedhin në të dytën që përshtat normat e së parës, por edhe në qendër që mund të jetë destabilizuar nga periferia. Kjo formë hibridizimi prodhon norma e praktika si ato që në kontekstin e Shqipërisë së veriut po dalin nga abuzimi me traditën.


3. SHPËRNDARJA GJEORAFIKE DHE NUMERIKE E FENOMENIT TË GJAKMARRJES

Të dhënat mbi shpërndarjen gjeografike e numerike të fenomenit të gjakmarrjes vaojnë ndjeshëm sipas burimeve që i kanë përpunuar. Për sa i përket shpërndarjes gjeografike të fenomenit, pjesa më e madhe e konflikteve ndodh në rrethinat e qyteteve kryesore të veriut e të qendrës së vendit, siç është e qartë nga kërkimet e bëra nga Operazione Colomba nga viti 2010 deri sot. Nga viti 2011 Operazione Colomba monitoron rezultatet e rasteve të hakmarrjes e gjakmarrjes në mediat shqiptare e ndërkombëtare, me vëmendje të veçantë që nga viti 2013. Baza e të dhënave e përpunuar në këtë mënyrë merr si burim shtypin e përditshëm në gazetatat: “Panorama”, “Shekulli” e “Gazeta Shqiptare”, me integrimin e publikimeve të tjera kombëtare si “Shqip” e “Mapo”, përveç informacioneve të rastit të marra nga mediat ndërkombëtare të shtypura de online. Megjithatë, të dhënat e sjella në artikujt e ekzaminuar na ofrojnë informacione që lidhen edhe me raste të largëta deri në vitet '80.

Në dhjetor të vitit 2017 baza e të dhënave e përpunuar nga Operazione Colomba përfshin 550 raste, ndër të cilat kemi raste plagosjeje, vrasje në tentativë, vrasje për shkak të hakmarrjes e gjakmarrjes. Disa artikuj sjellin në mënyrë të qartë forma gjakmarrjeje, të tjera janë kataloguar kështu nga stafi i Operazione Colomba mbi bazën e informacioneve që përmbajnë dhe lidhen me motivet tipike që çojnë në forma gjakmarrjeje. Raste të tjera janë kataloguar me qëllim që të monitorohen evoluimet e mundshme të ardhshme të situatave.

Në 550 raste totale të pranishme në bazën e të dhënave, rastet e gjakmarrjes vlerësohen se kanë qenë 48 e 275 të *hakmarrjes*. Disa prej këtyre gjakmarrjeve janë filluar nga episodet e mëparshme të *hakmarrjes*, pastaj ka degjeneruar në një ose më shumë cikle *gjakmarrjeje*. Rastet e tjera duhet të monitorohen sepse faktet që i karakterizojnë mund të sjellin pastaj ciklet e gjakmarrjes. Krahasuar me statistikën e bërë nga Operazione Colomba në vitin 2014, në periudhën e marrë në shqyrtim nga janari 2015 deri në dhjetor 2017, vërehet se si në tre vite kanë ndodhur 141 raste të reja të *hakmarrjes* e 15 raste të reja të *gjakmarrjes*.






Grafiku nr.1

Nga ajo që del nga baza e të dhënave, shkaqet e *hakmarrjes* e *gjakmarrjes* janë në pjesën më të madhe të rasteve të lidhura me çështje pronësie, konflikte të mëparshme dhe për çështje nderi. Nëse shkon më tej gjen arsye të tjera si: motive të dobëta, provokime verbale, larje hesapesh, borxhe, probleme pune dhe frika e pësimit të hakmarrjes për një fyerje të bërë që i shtyn autorët të godasin të parët. Qytetet në të cilat fenomeni i *hakmarrjes* dhe *gjakmarrjes* është shfaqur më shpesh janë në rend zbritës Tirana (me 86 fakte), Shkodra (me 46 fakte), Durrësi (me 36 fakte), Vlova (me 17 raste) e Lezhë (me 12 fakte). Më tej gjejmë pastaj: zonën e Krujës/Fushë-Krujës, Fierit, Tropojës e Laçit, Elbasanit, Beratit, Pogradecit, Dibrës, Malësisë së Madhe, Lushnjës, Sarandës, Pukës, Tepelenës, Kukësit, Mirditës, Gjirokastrës, Dukagjinit e Korçës.



SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E BRENDSHME



Grafiku nr. 2

Përveç fenomenit të gjakmarrjes në territorin shqiptar, për fat të keq, gjejmë edhe fenomenin e ashtuquajtur “Eksport i hakmarrjes”: disa raste vazhdojnë edhe jashtë kufijve shtetërorë. Prandaj, sipas të dhënave të mbledhura nga baza e të dhënave të Operazione Colomba nga viti 2013, disa vrasje për gjakmarrje janë konsumuar sipas përhapjes geografike që vijon: 11 raste në Itali, 4 raste në Greqi, 2 raste në Belgjikë, 2 raste në Francë, 2 raste në Gjermani e 2 raste në Holandë; vijon rasti i parë i sigurtë edhe në Kosovë, 1 në Mal të Zi, 1 në Mbretërinë e Bashkuar, 1 në Republikën Çeke, 1 në Suedi, 1 në Svicër; dhe përtej oqeanit: 1 në Kanada e 1 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Mosha e viktimave ndryshon shumë, nga një minimum 9 vjeç në një maksimum 91 vjeç, megjithatë pjesa më e madhe e viktimave lidhet me grupmoshën nga 20 deri në 60 vjeç.

Për sa i përket gjinisë së viktimave, pjesa më e madhe janë të gjinisë mashkullore (508 raste në 550), me një përfshirje jo e vogël edhe të personave të tjerë të gjinisë femërore (42 raste në 550). Përfshirja e këtyre të fundit rrjedh jo vetëm nga shkaqet e sipërpërmendura por edhe nga dhuna familjare (Par. 2).

VIKTIMAT E GODITURA NGA GJAKMARRJA



Grafiku nr.3

Kuptohet se si fenomeni është në zhvillim të vazhdueshëm dhe nuk është në rënie. Ai është tërthorë në disa kënvështrime sepse ka të bëjë me: zona të ndryshme në të gjithë Shqipërinë dhe del edhe jashtë kufijve shtetërorë, në bazë të vendit ku zhvendosen qytetarët me shtetësi shqiptare të përfshirë persona të të gjitha moshave dhe të dy gjinive pa dallim; periudha të gjera kohore deri në ditët e sotme. Analiza tregon sa dinamizëm i fenomenit e çon atë në manifestimet e tij të origjinës së Kanunit dhe gjithnjë e më të prirur për t'u futur në të papritura të kontekstit në të cilin përhapet.

Të dhënat në dispozicion variojnë dukshëm sipas burimeve. Dallojmë tri lloje burimesh: institucionet shqiptare, shoqatat shqiptare e ndërkombëtare *in loco*, organizatat ndërkombëtare.

Të dhënat e publikuara nga disa prej këtyre burimeve janë shpesh të marra nga të tjera. Për këtë arsye informacionet e mbledhura nga burime të tilla ndërliken me njëra-tjetrën.

Për sa u përket burimeve institucionale shqiptare, gjejmë të dhënat e mbledhura nga Avokati i Popullit dhe nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Të dhënat e mbledhura nga një studim i stafit të Avokatit të Popullit nga viti 1990 deri në vitin 2012, japin 6.000 të vdekur si pasojë e *gjakmarrjes*. Të dhënat e paraqitura nga qeveria nga viti 1991 deri në vitin 1995 tregojnë kryerjen e 953 vrasjeve, ndër të cilat 9,5% të kryera për shkak të *hakmarrjes* e *gjakmarrjes*. Vetëm në vitin 1997 rastet e vrasjeve të regjistruara nga Policia e Shtetit Shqiptar ishin 1542 dhe familjet e dëmtuara apo të përfshira në raste *hakmarrjeje* e *gjakmarrjeje* ishin 2910¹⁴.

14 Raport mbi gjakmarrjen i realizuar nga Policia e Shtetit Shqiptar, 2012 (Sadiku, 2013).

Në vitin 2012, Ministria e Brendshme ka zbuluar, për herë të parë, disa vlerësime zyrtare mbi fenomenin e *gjakmarrjes*. Sipas këtyre vlerësimeve, janë 225 vrasjet e bëra për *gjakmarrje* që kanë ndodhur në 12 vite (nga viti 1998 deri në vitin 2012¹⁵). Statistikat e Ministrisë së Brendshme mbi fenomenin tregojnë që këto 225 vrasje përfaqësojnë 7,9% të krimeve të bëra. Këtu poshtë sjellim shpërndarjen numerike të pjeshme të vrasjeve për *gjakmarrje* nga viti 1998 në vazhdim, sipas të dhënave të shpërndara nga Ministria e Brendshme. Është interesante të vëzhgosh ndryshimin e saj duke u nisur nga përqindja e regjistruar çdo vit. Sipas këtyre të dhënave prirja e fenomenit nuk është konstante. Megjithatë, fenomeni duket në rënie.

Vitet	Numri i vrasjeve	Numri i vrasjeve për <i>gjakmarrje</i>	Përqindja
1998	573	45	7.8%
1999	496	41	8.2%
2000	275	41	14.9%
2001	208	32	15.3%
2003	132	12	9%
2004	190	11	5.7%
2005	131	5	3.8%
2006	87	4	4.5%
2007	103	0	0%
2008	88	5	5.6%
2009	82	1	1.2%
2011	135	5	3.7%
2012	100	5	5%

Tabela nr. 1

Ndër informacionet e marra nga shoqatat shqiptare e ndërkombëtare *in loco*, gjegjë të dhënat e Komitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar të Tiranës, të shoqatës “Dukagjini” të Shkodrës¹⁶, të “Komisionit të Drejtësisë dhe Paqes” të Shkodrës dhe të Operazione Colomba. Raporti i hartuar nga Operazione Colomba në vitin 2014, sjell edhe studimin e 180 fakteve që u përkasin konflikteve, plagosjeve e vrasjeve, duke u nisur nga analiza e 276 artikujve të të përditshmeve kryesore lokale (Gazeta Shqiptare, Panorama, Shekulli) nga gushti i vitit 2011 deri në shtator të vitit 2014. Analiza dallon 134 raste që lidhen me motive të *hakmarrjes* e 33 të *gjakmarrjes*.

15 Burimi, e përditshmja *Gazeta Shqiptare*, 17 tetor 2012, nuk i citon shifrat që lidhen me 2002 e 2010.

16 Nga e përditshmja *Gazeta Shqiptare*, 17 tetor 2012.

Shoqatat	Viti	Zona	Vrasje për hak/ gjakmarrje
Komiteti i Pajtimimit Kombëtar	Nga 1991 deri 2009	Veri, qendër e jugi	9800
Shoqata “Dukagjin”	Nga 1991	Dukagjin	144
Komisioni Drejtësi dhe Paqe	Nga 1990 deri 2008	Shkodër, Malësi e Madhe	165
Operazione Colomba	Nga 1999 deri 2015	Tropojë, Dukagjin, Malësi e Madhe, Mirditë, Elbasan, Vlorë, Berat, Pogradec, Fier, Dibër, Lushnjë, Sarandë, Pukë, Tepelenë, Kukës, Gjirokastër, Korçë	204

Tabela nr. 2

Ndër organizatat ndërkombëtare gjejmë OSBE që sjell të dhënat e marra nga: Ministria e drejtësisë në vitin 2007; nga Komisioni Drejtësi dhe Paqe i Shkodrës në vitin 2010; nga Avokati i Popullit në vitin 2013; nga Komiteti i Pajtimimit Mbarëkombëtar të Tiranës nga viti 2013 deri në vitin 2014; nga institucionet fetare të Shkodrës në vitin 2014; nga *Children’s Rights Center of Albania* në vitin 2013¹⁷; nga Prokuroria e Shkodrës në vitin 2014.

17 Organizatë joqeveritare e pranishme në Tiranë në vitin 1997 me qëllim mbrojtjen e të drejtave të minorenëve.



	Persona të ndekur për shkak të hakmarrjes	Familje të ngjuara	Të rritur të ngjuar	Fëmijë të ngjuar	Familje në "gjak"	Viti
Ministria e Drejtësisë	13					2007
Komisioni Drejtësi dhe Paqe		138		120		2010
Avokati i Popullit	5	67	154 (në vitin 2012)	33	1559	2013
Komiteti i Pajtimit Kombëtar		980		306	4900	2013/2014
Institucionet fetare të Shkodrës		138		15	238	2014
Children's Rights Center of Albania						2013
Prokuroria e Shkodrës			36		196	2014

Tabela nr. 3

Përveç kësaj, organizata ndërkombëtare *Civil Rights Defenders* ka publikuar në gusht të vitit 2015 një raport mbi Shqipërinë, në të cilin citohet fenomeni i gjakmarrjes, duke e denoncuar ekzistencën e tij në të paktën 70 familje të ngjuara¹⁸.

Mund të vërehet mospërputhje në të dhënat. Nga njëra anë, disa funksionarë qeveritarë mbështesin që të dhënat e marra nga OJQ janë të tepërta, për të justifikuar kërkesën e një ndërhyrjeje urgjente nga ana e autoriteteve shqiptare. Nga ana tjetër, organizatat e pavarura akuzojnë autoritetet shqiptare për nënçmimin fenomenit, nga frika që ai të ngadalësojë mundësinë e hyrjes në *membershi-in* e Bashkimit Evropian. Për sa u përket rasteve të ndjekura drejtpërdrejt nga Operazione Colomba, bëhet fjalë për rreth 200 persona, të shpërndara në 31 familje në zonat qendrore dhe veriore të Shqipërisë. Si rrjedhojë, shpërndarja gjeografike dhe numerike: Rrethi i Tropojës: 7 familje; Rrethi i Shkodrës: 16 familje; Rrethi i Koplikut: 2 familje; Rrethi i Mamurrasit: 2 familje; Rrethi i Tiranës: 2 familje; Rrethi i Durrësit: 2 familje.

Në disa raste vullnetarët e Operazione Colomba njohin qoftë familjen që duhet të vendosë të bëjë hakmarrjen, qoftë atë që ka frikë që do ta pësojë atë. Në raste të tjera, në vend të kësaj, stafi i shoqatës është në kontakt vetëm me njërën nga palët e përfshira (ose me ata që duhet të vendosin nëse duhet ta bëjnë hak/gjakmarrjen,

18 Organizatë e themeluar në Stokholm në vitin 1982 për mbrojtjen e të drejtave njerëzore.



ose me ata që kanë frikë që do ta pësojnë). Prandaj, duke ndarë familjet e ndjekura në dy grupe, duket se: familjet që duhet të vendosin të bëjnë hak/gjakmarrjen: 11 familje, ndër të cilat: 3 në rrethin e Tropojës, 5 në rrethin e Shkodrës, 1 në rrethin e Mamurrasit, 1 në rrethin e Tiranës, 1 në rrethin e Durrësit. Familje që kanë frikë të pësojnë hak/gjakmarrjen: 20 familje, ndër të cilat: 4 në rrethin e Tropojës, 11 në rrethin e Shkodrës, 2 në rrethin e Koplikut, 1 në rrethin e Mamurrasit, 1 në rrethin e Tiranës, 1 në rrethin e Durrësit.

Familjet në konflikt të ndjekura nga Operazione Colomba në Shkodër e Tiranë u përkasin në pjesën më të madhe fiseve të ardhura nga Dukagjini e nga Tropoja (7 fise të zonës së Dukagjinit e 4 fise të zonës së Tropojës). Më shumë se gjysma e tyre janë zhvendosur në brendësi të vendit, sipas një procesi zbritjeje në periferitë e qyteteve nga zonat malore nga vijën, shpesh vetëm për t'u ikur pasojave të mundshme të shkaktuara nga gjakmarrja. Transferime të tilla brenda vendit shërbejnë për të ulur nivelin e tensionit mes palëve, por, për fat të keq, nuk janë garanci sigurie, sepse shoqëria tradicionale shqiptare është e themeluar mbi lidhje mes vetë familjeve, të cilave është e lehtë t'u nxirren informacione mbi prejardhjen e tjetrit. Shpesh edhe mbiemri i familjes tregon prejardhjen gjeografike dhe origjinën e personit duke e bërë të thjeshtë gjetjen edhe të atyre që janë transferuar diku tjetër.

Operazione Colomba fatkeqësisht nuk i ka mundësitë të monitorojë përhapjen e fenomenit në të gjithë territorin shqiptar, për shkak të mungesës së burimeve. Megjithatë, mbi bazë të kërkimeve të veta, edhe nëpërmjet shtypit të përditshëm, supozon që numri i familjeve të goditura nga fenomeni i gjakmarrjes të jetë më i lartë se ai i dhënë, dhe që zona gjeografike e interesuar për fenomenin është më e gjerë krahasuar me shpërdarjen e familjeve të njohura drejtpërdrejt. Prandaj, fenomeni i gjakmarrjes duket shqetësues dhe i shpërndarë në zona të gjera të territorit shqiptar, me ndonjë episod edhe jashtë shtetit. Në tre vitet e fundit të pranishëm në këtë fushë dhe në analizën e të dhënave të ardhura nga media lokale e ndërkombëtare, fenomeni duket konstant në përhapje e në ashpërsi.

4. ROLI I INSTITUCIONEVE SHQIPTARE NË LUFTËN NDAJ FENOMENIT TË GJAKMARRJES

Institucionet shqiptare janë përballur me fenomenin e gjakmarrjes sipas qëndrimeve të ndryshme vitet e fundit. Krahasuar me një të kaluar, në të cilën Shqipëria njihje një përhapje të kufizuar të fenomenit, nga viti 2012 deri sot autoritetet shqiptare kanë realizuar përmirësime të ndryshme. Presioni i panoramës ndërkombëtare dhe rritja në dukje e fenomenit në mediat lokale e ndërkombëtare kanë shtyrë të gjitha institucionet të merren me gjakmarrjen. Bashkimi Evropian ka qenë organizata kryesore kombëtare që i ka dhënë vëmendje veçanërisht gjakmarrjes, derisa e ka bërë zhdukjen e saj si një ndër kërkesat e hyrjes së vendit në *membership-in*



evropian. Në “Progres Report-in” e vitit 2013¹⁹, Komisioni Evropian risjell ngujimin e minorenëve, ndërsa “Motion for Resolution”²⁰ të të njëjtit vit Parlamenti Evropian kujton efektet negative që hakmarrja sjell, shtimin e dhunës dhe të vrasjeve. Edhe, Parlamenti Evropian u bën thirrje autoriteteve shqiptare për krijimin e një baze të dhënash statistikore mbi fenomenin dhe krijimin e Këshillit Koordinues kundër gjakmarrjes parashikuar nga ligji n. 9389 i vitit 2005.

Në vitin 2014²¹, 2015²² e 2016²³ Bashkimi Evropian ka vendosur kujtimin ndaj luftës për gjakmarrjen në paragrafin kushtuar mbrojtjes së të drejtave të jetës të Progress Report-it , që analizojnë përmirësimet e Shqipërisë në pikëpamjen e hyrjes në BE. Vit pas viti, BE i ka kërkuar Shqipërisë disa pika: krijimi i një baze të dhënash, aktivizimi i Këshillit Koordinues, përforcimi i shetit të të drejtës dhe programet e parandalimit të konflikteve.

Gjatë Universal Periodic Review të vitit 2014, edhe Këshilli i të Drejtave njerëzore i OKB i ka rekomanduar Shqipërisë krijimin e një baze të dhënash me rastet e gjakmarrjes dhe krijimin e Këshillit Koordinues në luftën ndaj fenomenit sipas ligjit 9389/2005²⁴.

19 European Commission (Commission Staff Working Document) (16.10.2013), *Albania 2013 Progress Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Enlargement Strategy and Main Challenges 2013-2014*, Brussels, pg.43; European Commission (Commission Staff Working Document) (8.10.2014), *Albania 2014 Progress Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, Enlargement Strategy and Main Challenges 2014-2015*, Brussels, f. 45.

20 European Parliament (9.12.2013), *Motion for a resolution to wind up the debate on the statement by the Commission pursuant to Rule 110(2) of the Rules of Procedure*, f. 7, pika 19; Human Rights Council, twenty-seventh session Agenda Item 6, Universal Periodic Review, United Nations General Assembly (7 July 2014), *Report of the Working Group on the Universal Periodic Review, Albania; Human Rights Council, twenty-seventh session Agenda Item 6, Universal Periodic Review (5 september 2014) Information presented by the Albanian People's Advocate (Ombudsman)*.

21 Në vitin 2014 Komisioni Evropian nënvizoi që “As regards the right to life, the blood feud phenomenon is still prevalent in the north of Albania. Certain cases have been reported also in the Tirana region, mainly due to rural migration. Figures on the number of victims of blood feuds as well as of families affected vary widely. Numbers seem to be stabilising, though, rather than increasing. While it is key to develop a homogenous and reliable database to keep track of the cases and families concerned, it is even more important that the rule of law is strengthened to ensure this phenomenon is eradicated. This would also put a stop to the fraudulent use of blood feud as an argument for unfounded asylum claims in member states” (f. 46 të Progress Report-it). E edhe “Cases of children confined to their homes for fear of retribution in blood feud conflicts persist” (f. 47).

22 Në Progress Report të 2015, Komisioni Evropian vuri në dukje: “As regards the right to life, blood feuds remain a problem, albeit on a limited scale. In March, parliament adopted a resolution and recommendations on blood feuds, based on the findings of the Ombudsman’s special report. The resolution calls for the coordination council on blood feuds set up in 2005 to be revived, for educational and social programmes to be run in rural areas, and for the prosecution and the police to step up investigation efforts and to invest more in preventing conflicts” (f. 57).

23 Në 2016, Komisioni Evropian shkruan që “As regards right to life, the March 2015 parliament resolution and recommendations on blood feuds still require follow up. The Coordination Council has to be reactivated” (f. 63).

24 *Report of the Working Group on the Universal Periodic Review - Albania*, 7 korrik 2014, f. 5, 6, 7, 10, 11, 13, 16, 22, 24.



Edhe institucionet e huaja janë interesuar për fenomenin e gjakmarrjes, që lidhen me kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare të qytetarëve shqiptarë. Në mars të vitit 2017, Komisioni Federal që merr dhe vendos në lidhje me kërkesat e mbrojtjes ndërkombëtare në Belgjikë ka publikuar një raport, të hartuar më vonë për një mision konstatimi të bërë në Shqipëri për të mbledhur informacione dhe për të thelluar kuptimin e fenomenit.

4.1. AFRIMI I INSTITUCIONEVE SHQIPTARE NDAJ FENOMENIT TË GJAKMARRJES

Afrimi i institucioneve shqiptare ndaj fenomenit të gjakmarrjes ka parë faza të ndryshme. Institucioneve shtetërore shqiptare u është dashur në kohë, të përballen me gjakmarrjen dhe me gjithë pasojat e saj. Në planin e brendshëm, institucionet shqiptare janë përpjekur të merrren me fenomenin fillimisht nga pikëpamja thjesht juridike, me një kuptim kriminalistik të veprimeve të parashikuara nga hakmarrja. Prandaj, në vitin 2013 ka pasur një modifikim legjislativ të Kodit Penal shqiptar, që ka parë shtrëngimin e dënimeve për ata që bëjnë një krim të lidhur me gjakmarrjen²⁵. Artikulli 78/a parashikon 30 vjet burg ose dënim të përjetshëm për vrasjen për gjakmarrje – i bërë kështu krim i vërtetë, jo vetëm rëndues – ndërsa artikujt 83/a e 83/b dënojnë me tre vjet heqje lirie kërcënimin për ngujim dhe nxitjen për vijim të gjakmarrjes²⁶.

Në vitin 2014 Prokurori i zonës së Shkodrës, nën ndikimin e Prokurorit të përgjithshëm të Tiranës, ka filluar një planifikim të familjeve në gjakmarrje, me vëmendje të veçantë ndaj familjeve të ngujuara. Edhe një plan specifik kundër gjakmarrjes duhet të aprovohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë²⁷. Janë regjistruar edhe raste në të cilat organet e Policisë kanë monitoruar situata hakmarrjeje për të parandaluar degjenerimin e tyre, me veprime garnizoni. Më 5 mars të vitit 2015 Parlamenti shqiptar ka votuar "Rezoluta për Parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri", duke pranuar publikisht ekzistencën e fenomenit dhe duke pohuar që është detyrë e shtetit ta përballojë e ta zhdukë. Gjithashtu ka pranuar që të njëjtat organe shtetërore nuk janë angazhuar akoma sa duhet për zhdukjen e fenomenit. Në dokument, Parlamenti dënon mungesën e aktualizimit të ligjit n. 9389/2005 dhe, për këtë qëllim, kërkon bashkëpunimin faktik të disa organeve shtetërore: Prokuroritë, organet e Policisë, administrata publike në tërësinë e saj. Institucioni i Avokatit të Popullit është marrë gjerësisht me fenomenin e gjakmarrjes, duke qenë kompetente në këtë kuptim me mandat të veçantë parlamentar. Në dhjetor

25 Ligji n. 144 i 2 majit 2013.

26 Të shikohet Kodi Penal shqiptar.

27 *Mid-Term report of Albania on the implementation of the recommendations received during the second cycle of Universal Periodic Review (UPR)*, mars 2017, f. 28.



të vitit 2015 ka publikuar raportin zyrtar mbi fenomenin²⁸, ku rekomandon nga ana e tij zbatimin e ligjit n. 9389/2005 dhe përfshirjen e institucioneve të ndryshme shqiptare. Pavarësisht nga mungesa e zbatimit të ligjit n. 9389/2005, në vitin 2015 në Shkodër ishte zhvilluar një bashkëpunim i parë nën ndikimin e OSBE dhe Avokatit të Popullit, që kishte përfshirë njësi të ndryshme të qeverisjes vendore dhe të shoqërisë civile. Ishin organizuar disa takime në muajt mars, prill e shtator me praninë e: përfaqësuesve të Bashkisë, Prefektit, Shërbimet sociale, zyra e Punës, përfaqësues nga Prokuroria, dhe përfaqësues të shoqërisë civile – ndër të cilët edhe Operazione Colomba. Megjithatë këtyre takimeve të para fatkeqësisht nuk u është dhënë vijimësi.

Në nëntor të vitit 2016 Ministria e Brendshme shqiptare ka promovuar një fushatë sensibilizimi kombëtare që mund të kishte ndikuar tangjent mbi fenomenin e gjakmarrjes. Fushata “Mos gjuaj, por duaj! – Don’t Shoot, but Love!” kundër armëmbajtjes pa leje mund të kishte kontribuar në kufizimin në të gjitha ato raste në të cilat ndonjë konflikt degjeneron lehtësisht në vrasje²⁹. Në Shqipëri, në fakt, pikërisht përhapja e gjerë e armëve të zjarrit, ose edhe të luftës (pushkë *kalashnikov* për shembull), është shpesh shkak i pasojave të pariparueshme që vijnë pas konflikteve me entitet të ulët. Iniciativa parashikonte mundësinë e dorëzimit të armëve të mbajtura jashtë ligjit pa asnjë ndjekje penale, brenda 30 prillit 2017. Për fat të keq, fushata nuk ka dhënë efektet e shpresuara dhe armët e dorëzuara te forcat e policisë kanë qenë në përqindje shumë të ulët në krahasim me ata që supozohet që janë mbajtur në shtëpitë e qytetarëve shqiptarë. Megjithatë, më 22 maj 2017 Shqipëria shpalli krijimin e një Komisioni kombëtar për armët e lehta, në optikën e një kontrolli më të madh të përhapjes së armëve në territorin e vendit.

Nga pikëpamja e të drejtës së qasjes për arsim, më 13 gusht 2013 është emetuar Udhëzimi n. 36 “Për procedurat e arsimit të fëmijëve të ngjuar”³⁰, i cili ka imponuar me ligj për Drejtoritë vendore të edukimit zbatimin e programeve edukative për të gjithë fëmijët e identifikuar si të ngjuar për çështje të lidhura me gjakmarrjen. Në shtator 2017, Drejtoria rajonale arsimore e Shkodrës i ka dërguar Bashkisë Shkodër, Bashkisë Vau – Dejës e policisë së zonës urdhrin³¹ të bashkëpunojnë e të sjellin informacione që lidhen me minorenët e ngjuar, meqë deri në atë moment, nga kërkimet pranë shkollave të zonës, asnjë minoren nuk rezultonte në kushte ngujimi.

Për sa i përket të drejtës për arsim, është parashikuar një program shkollarizimi në shtëpi nëpërmjet shkollave fillore (cikli i parë shkollor, *shkolla 9-vjeçare*), pra, arsimi i detyrueshëm bazë duket se është i garantuar.

28 Të shikohet: *Raport i veçantë “Mbi fenomenin e gjakmarrjes në Shqipëri”,* dhjetor 2015.

29 Fushata ishte promovuar në partnership me UNDP – SEESAC South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of the Small Arms and Light Weapons.

30 Udhëzimi n. 36 “Për procedurat për arsimin e fëmijëve të ngjuar”, 13 gusht 2013.

31 Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër, Sektori i shërbimeve të Përgjithshme, *Kërkesë për informacion* n. 2277, 13 shtator 2017.

Krahasuar, në vend të kësaj, me mbrojtjen e drejtpërdrejt të viktimave, jo gjithmonë hetimet e policisë kanë shkuar në rezultatet e shpresuara. Për shembull, vrasja e një burri 70 vjeç dhe e mbesës së tij 17 vjeçe e ndodhur më 14 qershor 2012, për qëllime gjakmarrjeje, nuk ka marrë akoma drejtësi. Grindja vazhdoi me kalimin e kohës, duke shkaktuar një tentativë tjetër për vrasje. Aty ku drejtësia shtetërore nuk arrin të përmbushet, mund të lindin forma të drejtësisë private. Pavarësisht nga thirrjet e shumta të shoqërisë civile për të hedhur dritë mbi këtë rast, fajtorët e vrasjes së dyfishtë nuk janë identifikuar akoma. Në të njëjtën kohë, në një rast tjetër, presioni pozitiv i bërë nga përfaqësuesit e Avokatit të Popullit ka bërë të mundur që Prokuroria të ishte veçanërisht e kujdesshme ndaj nevojave të familjes së viktimës në një rast vrasjeje për motive të grindjeve familjare.

Në përgjithësi, masat legjislative të miratuara nga shteti shqiptar për shtrëngimin e dënimeve jo gjithmonë shohin rezultate të prekshme në zbatimin e tyre konkret. Për më tepër, shpesh harrohet familja e viktimës, që nuk është pjesë e procedurës penale. Në këtë mënyrë, shteti merret – jo gjithmonë në të njëjtën mënyrë – me ndjekjen e faktorëve, por nuk e merr në konsideratë rolin e viktimave. Kujdesi ndaj viktimave, në një kontekst hakmarrjeje familjare si ai i shqiptar, është vendimtar për uljen e tensionit ndërmjet fiseve të përfshira dhe të shmangë vazhdimin e grindjes.

4.2 BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSTITUCIONEVE SHQIPTARE E OPERAZIONE COLOMBA

A. INSTITUCIONET SHTETËRORE

Nga viti 2010 deri sot marrëdhënia ndërmjet Operazione Colomba dhe institucioneve shqiptare është rritur me besim reciprok e bashkëpunim. Duke nisur që nga fushata sensibilizuese kombëtare “5000 firma për jetën” promovuar në vitin 2013, disa institucione i janë bashkuar mbledhjes së firmave (në veçanti, disa parlamentarë anëtarë të Komisioneve parlamentare në Parlamentin shqiptar), të tjerë si në atë kohë Presidenti i Republikës së Shqipërisë Bujar Nishani – i kanë vlerësuar objektivat³². Në vitin 2014 institucionet shqiptare kanë promovuar dhe mbështetur Marshimin për Page “Të ndryshosh? Mundesh! Një popull lëviz për paqen, kundër gjakmarrjes”. Nisma është dhënë nga Operazione Colomba, në bashkëpunim me shoqata të tjera³³, me objektivat që vijojnë: promovimi i kulturës së jetës, të paqes, të faljes e të pajtimit; arritja e një shikueshmërie më të gjerë edhe në nivel ndërkombëtar

32 Më 23 korrik 2014 një delegacion i Shoqatës Komuniteti Papa Xhovani XXIII - Comunità Papa Giovanni XXIII dhe Operazione Colomba ka takuar privatësisht presidentin e atëhershëm të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

33 Ambasadorët e Paqes; Drejtësi e Paqe; Shoqata Patriotike e Dukagjinit; Komuniteti Sant'Egidio; World Vision; Qendra e shërbimeve psikologjike për fëmijët e Shkodrës; Shoqata e Skautëve të Shqipërisë; Kryqi i Kuq Shqiptar (Ecje për paqen. Të ndryshosh? Mundesh! Një popull lëviz për paqen kundër gjakmarrjes).



të problemit të gjakmarrjes; inkurajimi i marrjes së një qëndrimi të fortë nga ana e institucioneve shqiptare nëpërmjet zbatimit në të gjitha nivelet të ligjit n. 9389 të 4 majit 2005. Në dhjetë ditë rreth 10.000 persona janë sensibilizuar mbi fenomenin e gjakmarrjes e mbi temën e pajtimit. Ngjarja parashikoi nënshkrimin nga ana e pjesëmarrësve dhe të mbështetësve të një apelimi që përmbante objektivat e nismës dhe angazhimin nga ana e të gjithëve për të promovuar pajtimin në më shumë nivele: individual, social, legjislativ e institucional. Apeli është nënshkruar nga 2681 persona, gati të gjithë shtetasit shqiptarë. Përveç shoqatave, Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesve të tjerë të institucioneve vendore që kanë marrë pjesë në nismë, kanë nënshkruar apelin edhe përfaqësuesit e institucioneve publike të kohës: Kryetari i Parlamentit Shqiptar Ilir Meta, Ministri i biznesit lokal Bledi Çuçi, Presidenti i Komisionit Parlamentar për sigurinë kombëtare Spartak Braho, Presidenti i Komisionit parlamentar për integrimin në Bashkimin Evropian Majlinda Bregu, Kryetarët e Bashkive të Pukës e Laç Vau -Dejes. 253 persona të tjerë që jetojnë jashtë shtetit kanë firmosur peticionin on-line. Suksesi i fushatës ka pasur shikueshmëri kombëtare e ndërkombëtare. Në vitin 2015, me rastin e zgjedhjeve administrative në të gjithë vendin, Operazione Colomba ka hedhur një nismë të re për sensibilizim kombëtar. Në fushatën elektorale, të gjithë kandidatëve për kryetarë Bashkie u është dërguar një pyetësor për fenomenin e gjakmarrjes, në mënyrë që të kërkojë në përfaqësuesit e ardhshëm të popullsisë civile një angazhim konkret për të çrënjësuar këtë praktikë. I njëjti pyetësor i është dërguar edhe kryetarëve të sapozgjedhur me qëllim kujtimin e angazhimeve të marra ndaj qytetarëve. Të gjitha rezultate e dala (përgjigje e marra dhe mungesa përgjigjesh) janë publikuar në blog-un <http://www.kundergjakmarrjes.org/> – një mjet i aksesueshëm lehtësisht online i krijuar në tri gjuhë që të konsultohet nga një publik italian, anglez e shqiptar. Rezultati i fushatës ka vënë në dukje një mosinteresim të përgjithshëm të institucioneve vendore kundrejt fenomenit të gjakmarrjes. Para së gjithash, është vënë re numri i vogël i përgjigjeve në fazën e parë parazgjedhore (7 përgjigje në 162 kandidatë), me një përmirësim në fazën paszgjedhore (24 përgjigje në 61 kryetarë). Një e dhënë e rëndësishme është prejardhja e përgjigjeve: pjesa më e madhe e përgjigjeve vijnë nga zona jugore e vendit, tradicionalisht më pak e prekur nga fenomeni i gjakmarrjes. Në vitin 2016 është hedhur një tjetër fushatë sensibilizuese në nivel kombëtar në dy qytete: Shkodra dhe Tirana “Të lidhim besën për... pajtim!”. Objektivi i fushatës ka qenë i dyfishtë: nga një anë, të kujtohen viktimat e fenomenit të gjakmarrjes, nga tjetra të propozojë një angazhim të institucioneve vendore dhe kombëtare në luftën ndaj fenomenit. Për të ndjekur objektivin e parë u është kushtuar viktimave të fenomenit një murale në Shkodër dhe një pllakatë, dhuruar nga Pallati i Kulturës Kamëz (Tiranë). Në fakt, në asnjë pjesë të vendit nuk kishte, deri në vitin 2016, monumente përkujtimore të viktimave. Gjesti ishte një mënyrë për t’u kthyer një formë të drejtësisë publike familjeve të viktimave. Për ndjekjen e objektivit të dytë, institucionet, e parashikuara nga Komisioni i Koordinimit për luftën ndaj fenomenit të gjakmarrjes, janë ftuar të bashkohen për të punuar bashkë për përcaktimin e

një strategjie të përbashkët kundër fenomenit, edhe në mungesë të zbatimit të ligjit n. 9389/2005. Ngjarjet janë realizuar në tre ditë takime publike, me përfshirjen e qytetarëve të Shkodrës e të Kamzës në Tiranë. Secila nga ngjarjet ka parashikuar një takim publik në shesh mbi temën e faljes dhe të pajtimit, projektimi i filmit “Falja e gjakut” me praninë e intervistës së aktorese protagonistë Sindi Laçe, krijimi i një pllakate në kujtim të viktimave të fenomenit të gjakmarrjes, që është e aksesueshme nga qytetarët. Në të dy qytetet janë organizuar tryeza të rrumbullakëta me institucionet, falë mbështetjes dhe bashkëpunimit të Avokatit të Popullit. Objektivi kryesor ka qenë ripërtëritja e angazhimit në parandalimin dhe luftën ndaj fenomenit të gjakmarrjes dhe përpunimi i një strategjie të përbashkët, siç është shprehur edhe nga dokumenti që është prodhuar dhe bashkëndarë pastaj. Pavarësisht nga pjesëmarrja e disa institucioneve në të dy tryezat e rrumbullakëta, në takime nuk është ndjekur asnjë nismë e përbashkët. Në nivel institucional vetëm përfaqësuesit e Avokatit të popullit kanë vazhduar bashkëpunimin e ndërmarrë me raste të veçanta të familjeve të përfshira në gjakmarrje.

Kohët e fundit disa institucione të pranishme në zonën e Shkodrës kanë organizuar aktivitete si përgjigje ndaj pasojave të fenomenit. Për shembull, në vitin 2015, Shërbimet sociale të Shkodrës kanë organizuar disa kurse profesionale për gratë që u përkasin familjeve në gjakmarrje, me qëllim që tu ofrohet atyre futja në botën e punës. Edhe në vitin 2016, disa anëtarë të shërbimeve sociale të Shkodrës janë marrë me disa familje të raportuara nga Operazione Colomba, për t’u përgjigjur nevojave sociale të ndonjë lloji. Falë një marrëdhënieje besimi reciprok, bashkëpunimi është i drejtpërdrejtë dhe i vlefshëm.

B. INSTITUCIONET FETARE

Bashkëpunimi me institucionet fetare ka qenë gjithmonë i vërtetë dhe i vlefshëm nga këndvështrime të ndryshme. Në planin e marrëdhënieve me familjet në gjakmarrje, ka ndodhur shpesh që meshtarët apo imamët e zonës të kenë ndjekur raste të caktuara bashkë me vullnetarët dhe familjarët, duke punuar bashkë për të shoqëruar viktimat e fenomenit drejt rrugës së pajtimit. Edhe përfaqësuesit e Kishës katolike dhe të Myftinisë myslymane të Shkodrës e të Tiranës kanë marrë pjesë gjithmonë në nismat e sensibilizimit të promovuara nga Operazione Colomba, duke u përfshirë vetë në fushata me karakter zonal e kombëtar. Përfaqësuesit e feve të ndryshme në terrtorin kombëtar kanë zbatuar strategji të ndryshme për luftimin e fenomenit të gjakmarrjes. Në vitin 2012 Ipeshkvinitë e veriut të Shqipërisë janë bashkuar për të shpallur një letër që parashikon shkishërimin për atë që vret për hakmarrje dhe rirryjen në kishë vetëm për ata që pendohen për veprat e dhunshme të bëra³⁴. Në vitin 2014, duke ndjekur Marshimin e Paqes, Operazione Colomba ka takuar

34 Dekret n. 96/2012 i 14 shtatorit 2012 lidhur me dokumentin: “Dokument i përshkrimit të fenomenit të gjakmarrjes për sensibilizimin e anëtarëve Parlamentit lidhur me kriminalitetin në Shqipëri”, tetor 2013.



Nuncin Apostolik, me të cilin ka bashkëndarë strategjinë e veprimit për zhdukjen e fenomenit të gjakmarrjes.

Edhe, Kisha katolike ka shfrytëzuar mundësinë e vizitës së Papës për të nisur një propozim formues lutjeje në të cilin promovohen zyrtarisht rrugët e pajtimit nëpërmjet tri etapave: pajtimi me veten dhe me të kaluarën personale; pajtimi me Zotin, pajtimi me të tjerët. Në pikën e fundit, Kisha ka bërë një apel të fortë ndaj familjeve në konflikt për t'u liruar nga problemi i hakmarrjes. Në mars 2017 dioqeza e Shkodrës i ka ofruar Operazione Colomba hapësirë për prezantimin publik të tekstit “Falja është një fitesë e madhe”, një mjet në mbështetje të atyre që kanë dëshirë të ndër marrin rrugën e pajtimit për të kapërcyer fenomenin e gjakmarrjes.

5. REKOMANDIMET

Duke u nisur nga, ekipi i Operazione Colomba propozon disa tregues të dobishëm për institucionet për të promovuar kapërcimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri, nëpërmjet përfshirjes së shoqërisë civile dhe të familjeve në konflikt.

- Mbështetje nëpërmjet rrugëve të ndërmjetësimit ndërmjet familjeve viktime të gjakmarrjes dhe krijimit të një procesi pajtimi kombëtar nëpërmjet përdorimit të drejtësisë restauruese (Par. 5.1. e 5.2).
- Zbatimi i reformave të organeve të drejtësisë shtetërore që parashikojnë: luftën ndaj korrupsionit, kujdestari paraprake të atyre që kanë bërë krime që lidhen me gjakmarrjen, siguria e dënimit, zbatimi i një drejtësie të barabartë për të gjithë.
- Zbatimi i mjeteve juridiko/institucionale të përshtatshme për të promovuar një proces të kapërcimit të fenomenit dhe të njohjes dhe kundërshtimit të veprave që provokojnë dhe ushqejnë hakmarrjen, si ligji për ndërmjetësimi civil i mosmarrëveshjeve³⁵.
- Rishikim dhe aktualizim i ligjit n. 9389 të 4 majit 2005 veprim për të krijuar një Këshill Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes (Par. 5.2).
- Prezantim sistematik i programeve edukative e kulturore të bazuara në drejtimin jo të dhunshëm të konflikteve, mbi edukimin për paqe, mbi pajtimin e respektin e të drejtave njerëzore në shkolla, në vendet e punës dhe në qendrat më të rëndësishme të grumbullim social.
- Marrja e masave të nevojshme për të garantuar sigurinë e qytetarëve viktime të hakmarrjes dhe të aksesit të tyre në shërbimet bazë (spitale, vende pune, shkolla, etj.).
- Krijimi i një fondi dëmshpërblyes dhe mbështetjeje për familjet që kanë pësuar zi për shkak të fenomenit.
- Krijimi, brenda organeve të policisë, i një shërbimi ndërhyrjeje të shpejtë *ad hoc* për rastet e gjakmarrjes.

35 Ligji n. 10385, datë 24.02.2011.



- Prezantimi dhe zbatimi i programeve specifike të burgjeve dhe rrugë të vazhdueshme riedukimi dhe riintegrimi të të bugosurve, që kanë bërë krime të lidhura me fenomenin.
- Krijimi i kritereve të përbashkëta që lejojnë identifikimin e familjeve të përfshira në fenomenin e gjakmarrjes.
- Dhënia e informacioneve shpjeguese të fakteve zyrtare krahasuar me qëndrueshmërinë reale të fenomenit të gjakmarrjes.
- Ndërtimi i një shteti social për të përballuar faktorët strukturorë që i lejojnë ekzistencën fenomenit, dhe që të kontribuojë në zhvillimin e kolektivitetit në nivel ekonomik, kulturor dhe në nivelin e ofrimit të shërbimeve.

Disa prej treguesve të sipërpërmendura janë shprehur në vitin 2014, nga një delegate e Shoqatës Comunità Papa Giovanni XXIII në Gjenevë sipas ciklit të mbedhur nga Këshilli i të Drejtave Njerëzore i OKB mbi Shqipërinë.

Disa prej këtyre treguesve do të thellohen duke u nisur nga përvoja e Operazione Colomba me qëllim që të përshkruajnë se cilat praktika të mira mund të mbështesin:

- realizimi i rrugëve të ndërmjetësimit, të aftë për të zgjidhur çdo grindje të shpërthyer nëpërmjet arritjes së një pajtimi ndërmjet palëve;
- zbatimi i një procesi pajtimi të përgjithshëm, të destinuar për të kapërcyer fenomenin e gjakmarrjes në kompleksitetin e tij.

5.1 RRUGE NDËRMJETËSIMI

Ashtu si dinamikat e konflikteve të lidhura me fenomenin e gjakmarrjes po heshtin në kohë, edhe praktikatat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mund të modifikohen, nëse kjo gjë do të thotë të bëhen mjete të vlefshme në mbylljen e mosmarrëveshjeve. Ndërmjetësia është një teknikë e një *alternative dispute resolution* që parashikon ndërhyrjen e një pale të tretë në konflikt e protagonistët e të cilëve mund të jenë individë, organizata, bashkësi ose grupe etj. Ndërmjetësimi i ndihmon palët të përcaktojnë faktet; kuptojnë qëllimet e sjelljeve të mbajtura; të pranojnë pozicione të ndryshme; të integrojnë kontributin e plaëve; të japë ide të reja të përshtatura për të arritur një marrëveshje.

Në kontekstin shqiptar, ndërmjetësimi është parashikuar në traditën e Kanunit si mjet i zgjidhjes së konflikteve dhe të mosmarrëveshjeve. Në këtë rast, pajtimi përkon me stadin e fundit të procesit të ndërmjetësimit. Praktikatat tradicionale të *peacebuilding* sjanë rrënjosur në bashkësitë e zonës dhe përfshijnë metoda të përdorura ndërmjet shekullit XIX e XX, disa prej të cilave janë rimarrë më vonë pas rënies së komunizmit. Afrimet tradicionale janë të lidhura ngusht me të shkuarën social-kulturore të zonës. Kodi parashikon, pra, dy “detyra-të drejta” të mundshme: ajo e marrjes së gjakut dhe ajo e faljes së familjes kundërshtare (Par. 1). Falja bëhet nëpërmjet procesit të ndërmjetësisë. Ndërmjetësit janë figura të bashkësisë që, nëpërmjet autoritetit të tyre moral, drejtojnë ndërhyrjen e ndërmjetësimit, duke ndikuar pikëpamjet dhe

sjelljet e palëve në konflikt. Ndërmjet këtyre figurave gjejmë përfaqësuesit fetarë, bajraktarët, misionarët e paqes, individë të veçantë dhe fise që nuk kanë lidhje gjaku me fiset në konflikt.

Ndërmjetësve u janë rezervuar qëndrime të ndryshme sepse pritsmëritë lidhur me këshillat e tyre janë të larta. Sipas të kaluarës tradicionale të kolektivitetit te zonës sa më i lartë të jetë statusi social i ndërmjetësit aq më i respektuar do të jetë mendimi i tij. Për shembull, në fushën fetare, priftërinjtë katolikë dhe ortodoksë drejtojnë zakonisht ndërmjetësimin ndërmjet familjeve katolike dhe/ose ortodokse në konflikt, ndërsa ai që kremton ritin e pajtimit ndërmjet palëve është ipeshkëvi. Imami është ai që ndërmjetëson ndërhyrjen ndërmjet fiseve të fesë islame dhe që vulos pajtimin ndërmjet palëve. Kur familjet në konflikt u përkasin feve të ndryshme, përfaqësuesit e tyre fetarë vihen në kontakt për të realizuar procesin e ndërmjetësimit dhe të bashkëndajnë ritin e pajtimit. Ndërmjetësit mund të ndërhyjnë vetëm ose në grup për të përforcuar veprimin e tyre. Zakoni shqiptar pranon mundësinë e heqjes dorë nga gjakmarrja nëpërmjet pajtimit të gjakut. Deri në gjysmën e parë të 900-ës, pajtimi i gjakut bëhej duke ndjekur praktikat formale me përbërjen miqësore të krimit falë ndërhyrjeve të të tretëve, nëpërmjet shpalljes së një bese të përgjithshme e nëpërmjet pajtimeve të përbashkëta të promovuara nga asamble spontane. Nëpërmjet negociatave të gjata ndërmjetësit kërkonin të arrinin në akord ndërmjet palëve. Është e nevojshme të kemi parasysh që kërkesa për falje të dorasit dhe e pajtimit me fisin e tij nënkuptonte një sforcim nga ana e familjes së viktimës që mund të krijonte situata parahatë mes tij edhe ndërmjetësit. Pajtimi arrihej duke dërguar persona të respektueshëm dhe ndërmjetës të moshuar që theksonin që të falësh është sinonim i nderit, burrnisë e besës. Veprimi mund të mbështetej edhe nga ndërhyrja e disa të afërmeve autoritarë të viktimave. Të gjithë anëtarët e familjes që kishte pësuar një zi duhet të ishin dakord mbi zgjedhjen e pajtimit dhe kur kryefamiljari ishte shumë i ri, pritej që të arrinte në moshë madhore që të mund të vendoste atë që do të bëhej. Ndërmjetësit “shpluhurosni” ligjet e vjetra të Kanunit për të përfunduar ndërmjetësinë në pajtim të gjakut. Pajtimi përfundonte me një veprim formal në të cilin merrnin pjesë më të afërmit, ndërmjetësit fetarë në shtëpinë e të vvarit dhe i garantit³⁶, ose këta të fundit së bashku me kryefamiljarët, anëtarëve të familjes dhe përfaqësuesve të Shtëpisë Gjomarka³⁷ dhe të flamurit. Një herë që është vendosur marrëveshja, pajtimi sanksionohej me një drekë ndërmjet palëve. Aktualisht, mënyra me të cilën këto funksione janë zhvilluar mund edhe të përfhijnë mjete ndërmjetësimi të reja, është bërë në fakt e nevojshme të kulturohen disa elementë tradicionalë të ndërmjetësimit dhe pajtimit, duke i rinovuar dhe përshtatur me kontekstin bashkëkohor të mosmarrëveshjeve derisa të mund të rezultojnë më të vlefshëm ndaj mbylljes së konflikteve. Ndër ta, po përshkruajmë disa.

36 Garantët prezantonin ritin e pajtimit, caktonin datën e pagesës së çmimit të dhe siguroheshin që betimi i pajtimit të mos shkelej me kalimin e kohës.

37 Fis pasues i Princ Lek Dukagjinit që ka pasur rolin e gjykatësit dhe të administruesit të ligjit zakonor deri në mesin e shek. XX.



- Individë të vetëm e grupe të pavarura të lidhur me subjekte individuale dhe shoqata mund të bëjnë rolin e ndërmjetësit jashtë asaj të parashikuar nga tradita. Mund të mbulojnë këtë funksion edhe ndërmjetësit si për shembull përfaqësuesit fetarë, me origjinë të huaj, meqë Kanuni zbatohet në mënyrë të tjetërsuar dhe ndërmjetësit me origjinë shqiptare mund të pësojnë kërcënime për fisin e tyre.
- Prania e figurave femërore, për të favorizuar komunikim me gratë që kanë pësuar një zi me qëllim që të këshillojë pozitivisht vendimet e tyre.
- Procese ndërmjetësimi të llojit *problem solving*, rrëfyese dhe transformuese. Lloji i parë i ndërmjetësimi ka qëllim të arrijë negocimin e nevojave të palëve. Nëpërmjet tij ndërmjetësit i ndihmojnë palët të reflektojnë mbi pasojat negative të ardhura nga zgjedhja për të hakmarrë, kundrejt atyre pozitiveve të sjella nga zgjedhja për të falur. Ndërmjetësit mund të promovojnë arritjen e një akordi ekonomik në formë dëmshpërblimi të përdorur edhe në të shkuarën për të dëmshpërblyer viktimat. Në këtë rast, palët e treta duhet të kenë parasysh që krijimi i një paqeje të qëndrueshme varet nga brendësimi i zgjedhjes së pajtimit të ndërmarrë, më shumë se nga shpërblymi ekonomik parashikuar në zakon.

Ndërmjetësimi rrëfyet përfshin, edhe njohjen e historisë së dhimbjes që shqëron konfliktin, por edhe e historisë së shpresës që, gjatë rrëfimit të viktimave lë të shikohet një mundësi e mbylljes konstruktive të armiqësisë. Kur një palë e tretë e bën të qartë këtë aspekt të dytë, përshkruhen hapat që palët duhet të ndjekin për të transformuar historinë e shpresës në realitet. Kjo u lejon ndërmjetësve të ndihmojnë viktimat nga një anë të komandojnë dhe të drejtojnë në mënyrë konstruktive emocionet e tyre negative; e nga tjetra të racionalizojnë përvojat e tyre emotive me qëllim që të ndërtojnë një rrëfim të ri të konfliktit, që përfshin mundësinë e transformimit të marrëdhënieve të armiqësisë. Ndërmjetësimi transformues parashikon, në fund, ndryshimin e *forma mentis* të personave të përfshira, nëpërmjet *empowerment* e njohjes reciproke. Empowerment është një proces që shton vetëdijen e individëve dhe të grupeve kundrejt afësive të tyre të drejtimit e zgjidhjes konstruktive të problemeve.

Njohja promovon edhe kuptimin, zhvillimin e empatisë dhe aprovimin kundrejt tjetrit dhe pikëpamjes së tij.

- Bashkëndarja, të dëgjuarit aktiv dhe barazvlefshmëria ndaj palëve i lejojnë ndërmjetësit të fitojë besimin e nevojshëm për të marrë besueshmëri, për të drejtuar ndërmjetësimin drejt pajtimit. Ndërmjetësit që ndërhyjnë në mosmarrëveshje ndërfamiljare mund të bashkëndajnë vuajtjet e të dyja palëve në konflikt, nëpërmjet të dëgjuarit aktiv. Mund të mbështesin familjet në drejtimin konstruktiv të emocioneve, me qëllim që t'i ndihmojnë të drejtojnë në mënyrë pozitive mllëfin për padrejtësitë e pësuar. Mund të favorizojnë rrugën e shërimit të plagëve të tyre emocionale. Në këtë mënyrë palët mund të ripërpunojnë dhimbjen, zinë e konfliktin.
- Dialogu përfshin përdorimin e fjalës si mjet veprues për të këshilluar pozitivisht vendimet e familjes dhe të ndërtojnë një akord ndërmjet palëve, duke i adresuar drejt një forme drejtimi jo të dhunshme të konfliktit.

- Zhvillimi i empatisë për të ndihmuar palët “të vihen në vendin e tjetrit”, në mënyrë që të promovojnë ndryshimin e përceptimit negativ të vepruesve në konflikt.
- Përdorimi i praktikave të drejtësisë restauruese (Par. 5.2), nëpërmjet elementeve pozitive të kulturë tradicionale shqiptare si falja dhe pajtimi, që mund të rezultojnë katalizatorët e procesit të destinuar të ndihmojë viktimat e fenomenit për të lënë urrejtjen dhe mllefet. Gjatë rrugës, viktimat mund të mbështeten nga procesi i përpunimit të jetës së tyre personale, ndërsa të afërmit e tij që ka bërë krimin mund të ndërmarrin veprime konkrete për të kompensuar viktimat dhe riparuar dëmet e bëra.
- Ritet e faljes dhe pajtimit mund të realizohen nëpërmjet kremtimeve publike që kanë qëllim të garantojnë një paqe të qëndrueshme ndërmjet familjeve sepse riti bëhet përballë kolektivitetit, figurave fetare të autorizuara dhe në vende të shenjta. Publikimi i ngjarjes mund të ndikojë pozitivisht mbi presionin social.
- Figura, që nëpërmjet pranisë së tyre, i mbështetin palët në zgjedhjen e tyre të pajtimit, gjatë procesit të ndërmjetësimit dhe pas rritit të pajtimit duke garantuar mbajtjen e lidhjeve pozitive ndërmjet palëve.

Edhe presioni pozitiv social që i tërheq elementët pozitivë të kulturës tradicionale të zonës, mund të mbështetet nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese drejtuar shoqërisë civile. Proceset e ndërmjetësimit kanë kohë të gjata. Në shumë raste këta persona edhe pse nuk i çojnë në një pajtim zyrtar të palëve, shërbejnë për të bërë të mundur që jeta e viktimave të konflikteve të mund të kthehet në normalitet. Ai që ka pësuar zinë, mund të rifillojë të projektojë të ardhmen e vet. Ai që ka lidhje gjaku me fyesin mund të dalë nga frika.

5.2 PROCESI I PAJTIMIT TË PËRGJITHSHËM

Proceset e pajtimit të përgjithshëm bazohen në praktikën e drejtësisë restauruese që ka qëllim të riaftësojë viktimat dhe autorët e krimeve në shoqëri. Drejtësia restauruese nxit shtigjet e rimëkëmbjes, afrimit dhe faljes në të cilat viktimat kryesuesit janë subjekte aktive. Nëse krimi dëmton ose shkatërron marrëdhënien midis individëve dhe grupeve, drejtësia restauruese ka për detyrë të rindërtojë bazat për lindjen e një marrëdhënieje të re ndërmjet tyre. Ajo promovon ndryshimin e përceptimeve të palëve nëpërmjet ripërpunimit dhe shërimit të përjetimeve emocionale të çdo vepruesi social. Riaftësimi i viktimave dhe rikuperimi i ekzekutuesve ndodh duke dalluar individin ose grupin nga abuzimi i bërë, nëpërmjet një procesi reciprok, në të cilin rrëfimi i përvojës personale i jep dinjitet rrëfyesit dhe dëgjuesve. Suksesi i drejtësisë restauruese nuk matet nga sasia e dënimeve të shkatuara, por nga sasia e riparimeve dhe riaftësimeve të bëra. Një shembull i qartë i drejtësisë restauruese është pajtimi. Të realizosh procese pajtimi të përgjithshëm do të thotë të krijosh një kontekst në të cilin ai që ka fyer motivohet për të ndryshuar situatën dhe marrëdhëniet me viktimën në mënyrë pozitive e të qëndrueshme. Veçanërisht



në konfliktet e grupit, dënimi i fajtorëve nuk u ndalon as atyre e as pasardhësve të mëvonshëm të vazhdojnë të urrejnë e të dëshirojnë të hakmerren. Proceset e pajtimit kanë nevojë, edhe, për krijimin e institucioneve në të cilat e vërteta dhe drejtësia mund të realizohen. Mund të dallojmë: komisioni i së vërtetës dhe pajtimit, gjykata, masa riaftësimi dhe riparimi, sipas aftësisë ligjore dhe natyrës së ndarjeve sociale në kontekstin në fjalë. Prandaj, proceset e pajtimit të përgjithshëm nuk janë të gjata, por realizohen në një hark të caktuar kohor, derisa drejtësia restauruese të mund të shërojë shkeljet e të drejtave të njeriut, edhe të shkaktuara nga forma të drejtësisë private, dhe të promovojë pohimin e drejtësisë shtetërore. Analiza e shkaqeve të fenomenit të gjakmarrjes tregon që prania e shtetit, promovimi i një procesi transformimi kulturor, garancia e respektit të ligjeve dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve mund të favorizojnë kapërcimin e fenomenit. Në këtë mënyrë, besimi ndërmjet komunitetit dhe shtetit mund të rindërtohet. Një proces pajtimi i përgjithshëm mund të parashikojë këto elementë sepse parashikon: takime të hapura me eksponentë të shquar të bashkësisë dhe viktimat e abuzimit; shoqërimin e fajtorëve drejt një rruge shërimi; krijimi i formave të riregullimit kundrejt viktimave. Para së gjithash, drejtësia restauruese përfshin një formulë të veçantë aktualizimi, domethënë, duhet t'i përshtatet kontekstit shqiptar për të favorizuar çrrënjosjen e fenomenit të gjakmarrjes. Në këtë kuptim, formula e drejtësisë restauruese “pajtim në këmbim të drejtësisë shtetërore” mund të karakterizojë procesin e pajtimit të përgjithshëm në Shqipëri.

Adaptimi i drejtësisë restauruese ka qëllim të promovojë funksionimin e drejtësisë shtetërore dhe të favorizojë praktikën e pajtimit për të shëruar konfliktet ekzistuese dhe për të parandaluar ata të ardhshme. Sipas kësaj formule, përdorimi i drejtësisë restauruese, nëpërmjet proceseve të ndërmjetësimit, do të kishte funksion të mbyllte përfundimisht mosmarrëveshjet dhe të garantojë sigurinë e dënimit. Aktiviteti i ndërmjetësimit mund të drejtohet në mënyrë private për të mbrojtur familjet e përfshira, në veçanti ato të viktimave. Nga njëra anë, pajtimi ndërmjet familjeve në konflikt do të përjashtonte të afërmit e atyre që kanë bërë një krim nga mundësia e pësimi të një hakmarrjeje dhe do t'u lejonte atyre të dilnin nga situata e ngujimit. Nga ana tjetër, pajtimi do t'i lejonte atij që ka bërë krim të kthehet në të përditshmen e vet pa frikë për pasojat, ku ai e ka paguar detyrimin ndaj drejtësisë shtetërore. Prandaj, të arratisurit mund ta kenë mundësinë të dalin hapur me qëllim që të promovojnë një pajtim ndërmjet palëve që mund të favorizojë sigurinë, kur është kryer dënimi, dhe përjashtimi i anëtarëve të familjes së tyre nga pasojat e hakmarrjes. Së dyti, për të kapërcyer çrregullimet shoqërore të shkaktuara nga fenomeni janë të nevojshme masat që të përballen edhe me mentalitetin në të cilin vetë fenomeni ushqehet. Angazhimi i drejtësisë restauruese mund ta përmbushë këtë funksion të dytë nëpërmjet praktikës së faljes dhe të pajtimit, meqë këto elementë pozitivë janë rrënjësor në kontekstin social-kulturor të zonës dhe mund të mbështesin parimet demokratike në gjendje për të mbrojtur të drejtat njerëzore. Disa mënyra të thëni si “burrë i vërtetë është ai që fal, jo ai që vret” dhe “kush fal gjakun është



mbimbretin tregojnë se sa falja është e konsideruar si një gjest i respektueshëm i traditës kulturore shqiptare. Por për të shmangur zbatimin e traditës përsëritëse, praktika që ushqejnë fenomenin, mund të rezultojë e nevojshme të bëhen pjesë e kulturës elementët e faljes dhe të pajtimit. Për shembull, të transformosh konceptin e “burrë i vërtetë është ai që fal, jo ai që vret” në “heroi i vërtetë është ai që fal, jo ai që vret” mund ta përtërijë konceptin tradicional. Proceset e kulturimit mundën edhe të përforcojnë dhe përshtatin elementët pozitivë të kulturës tradicionale shqiptare me kontekstin e Shqipërisë bashkëkohore. Së treti, viktimat e fenomenit mund të jenë të parat dhe marrësit e drejtpërdrejtë të programeve të shërimit, asistencës dhe rehabilitimit të organizuara nga institucionet. Viktimave mund t’u destinohet një hapësirë dëgjimi e rezervuar dhe private në të cilën të mund të tregojnë padrejtësitë e pësuar, ripërpunimin e dhimbjes në mënyrë konstruktive dhe kanalizimi pozitiv i kërkesave të tyre për drejtësi. Mbrojtja e privatësisë së viktimave të fenomenit është thelbësore për të shmangur paraqitjen e traumave të tjera. Së katërti, kushtëzimi i një fondi dëmshpërblymi shtetëror drejtuar familjeve që janë në zi për shkak të fenomenit mund të ketë si qëllim të njohë dëmin, të krijojë një formë shpërblymi për padrejtësinë e pësuar dhe përmirëson kushtet social-ekonomike të viktimave të hakmarrjes.

Së pesti, procesi i drejtësisë reatauruese mund të drejtohet nga figura me autoritet si intelektualë, kryepleq të fshatit, përfaqësues fetarë e institucionalë. Prania e figurave me autoritet, që drejtojnë procesin e drejtësisë restauruese “duke mishëruar” elementët pozitivë të kulturës tradicionale shqiptare, mund të promovojë procesin e transformimit kulturor sepse autoriteti i rolit të tyre i jep besueshmëri punës së tyre. Figurat me autoritet mund të kenë detyrë të ndryshojnë mentalitetin sipas të cilit hakmarrja është më e nderueshme se falja, duke mbështetur atë që jeta është më e rëndësishme se çdo lloj vlere tjetër dhe që praktika e pajtimit e pohon këtë parim. Transformimi i mentalitetit që karakterizon fenomenin gjithashtu, mund të promovohet nga një anë nga dëshmitë e atyre që kanë vendosur të falin vrasjen e një të afërmi dhe të pajtohen me palën tjetër. Nga ana tjetër nga programe edukimi për jodhunën dhe respektimin e të drejtave njerëzore të destinuara për komunitetin. Së fundmi, promovimi dhe publikimi i vazhdueshëm i nismave kundër fenomenit nga ana e mass medias mund të dokumentojnë në mënyrë transparente procesin e pajtimit të përgjithshëm, por edhe të përhapin dhe plotësojnë mesazhet. Në këtë mënyrë, mund të promovohet një presion social pozitiv, i aftë për të mbështetur zgjedhje të tjera faljeje dhe pajtimi ose të dekurajojnë përdorimin e hakmarrjes. Ka megjithatë pengesa të ndryshme në zbatimin e këtij modeli. Nga një anë, është e nevojshme që të pihen kohët për të krijuar këtë proces dhe për ta mbështetur, lindja e ndërjegjes civile mund të jetë element nxitës. Nga ana tjetër, është e përshtatshme të ndërtohet një urë mes qendrës dhe periferive me qëllim që të bashkohen komunitetet zonale me qëllim që ta kundërshtojnë fenomenin. Shënohet kufizimi që vjen nga mungesa e një impulsi të fortë; në Shqipëri ndoshta shtytja evropiane mund të ndërtojë një gjendje të mjaftueshme për të krijuar një lëvizje në



kohezion dhe të vendosur të kundërshtojë fenomenin. Nga pikëpamja normative, ligji n. 9389 të 4 majit 2005 është një mjet që ndan një strategji në të cilën sforcimet e institucioneve dhe të vepruesve të shoqërisë civile kanalizohen në luftën ndaj fenomenit. Ky ligj parashikon, në fakt, krijimin e një Këshilli Koordinues që të zbatojë një strategji kombëtare me kohëzgjatje për të përcaktuar parandaluar, kundështuar dhe zhdukur fenomenin e gjakmarrjes, nën drejtimin e përfaqësuesve institucionalë dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve fetarë dhe të organizatave jofitimprurëse që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nga data e daljes së ligjit kanë kaluar mbi dymbëdhjetë vite. Ligji nuk është zbatuar akoma dhe disa aspekte të normativës mund të kenë nevojë të rishikohen në dritën e kontekstit social-politik aktual.

Edhe pse nuk ekziston asnjë garanci për realizimin e modelit të përshkruar më sipër, në çfarëdolloj forme ai ose disa nga elementët e tij të realizohen, duhet pasur parasysh para së gjithash ajo që përvijua. Së dyti, nga nevoja e ndërtimit të besimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve; së fundmi nga urgjenca e favorizimit të ndryshimit të kulturës që ushqen fenomenin.



BIBLIOGRAFIA

- Alston P. (20 May 2010), *Report of the Special Rapporteur on extra-judicial, summary or arbitrary executions*, Human Rights Council, United Nations General Assembly.
- Archivio casi *hakmarra* e *gjakmarra*, Operazione Colomba – Associazione Comunità Papa Giovanni XXIII dal 2011 ad oggi, fonti “Gazeta Shqiptare”, “Panorama”, “Shekulli”.
- Associazione Comunità Papa Giovanni XXIII (25 August 2014), *Written statement submitted by the Associazione Comunità Papa Giovanni XXIII, a non-governmental organization in special consultative status*, Human Rights Council General Assembly (Geneva), Twenty-seventh session Agenda item 6 Universal Periodic Review.
- Basso R. (2011), *Kanun, il sangue e l'onore*, Padova: Running TV International.
- Bego F. (2014), La storia dell'Albania dal 1997 e l'identità albanese del post-comunismo, *Storicamente*, 10 (26).
- Besemer C. (1999), *Gestione dei conflitti e mediazione*, Torino: EGA Editore.
- Bissi A. (1999), *Il battito della vita. Conoscere e gestire le proprie emozioni*, Roma: Edizioni Paoline.
- Bowling D., Hoffman D. (2000), Bringing peace into the room: the personal qualities of the mediator and their impact on the mediation, *Negotiation Journal*, 16(1): 5-28.
- Bush B. R. A., Folger J. P. (2009), *La promessa della mediazione: l'approccio trasformativo alla gestione dei conflitti*, Firenze: Vallecchi.
- CAMPAGNOLI M. (2007/2008), *IL FENOMENO DEL KANUN E LA DIMENSIONE EDUCATIVA: UN'ANALISI*, TESI DI MASTER UNIVERSITARIO SULLA DIMENSIONE EDUCATIVA DELLA COOPERAZIONE INTERNAZIONALE, DIPARTIMENTO DI SCIENZE DELL'EDUCAZIONE, FACOLTÀ DI SCIENZE DELLA FORMAZIONE, UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI BOLOGNA.
- Capitini A. (1989), *Le tecniche della nonviolenza*, Milano: Linea d'ombra.
- Capra S. (2000), *Albania proibita: il sangue, l'onore e il codice delle montagne*, Milano: Mimesis.
- Committee of Nationwide Reconciliation (2009), *National Strategy against blood feud. Strategic plan for the elimination of enmities and integration in EU without blood feud*, Tirana.
- Corella R. (2013), *Prisioneros del Kanun*, Spagna: Grafo Documental.



- Cozzi E. (1910), *La vendetta del sangue nelle Montagne dell'alta Albania*, *Anthropos*, 5: 654-687.
- D'Alessandri A., Pitassio A. (2011), *Dopo la pioggia. Gli Stati della ex Jugoslavia e l'Albania (1991-2011)*, Lecce: Argo.
- Davis J. (1997), *Antropologia delle società mediterranee. Un'analisi comparata*, Torino: Trauben.
- Elezi I. (2000), *Vrasjet për hakmarrje e për gjakmarrje në Shqipëri*, Tirane: Botim i Qendres Shqiptare re per te Drejtat e Njeriut.
- European Commission (Commission Staff Working Document) (16.10.2013), *Albania 2013 Progress Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Enlargement Strategy and Main Challenges 2013-2014*, Brussels.
- European Commission (4.06.2014), *Report from the Commission to the Council and the European Parliament on Albania's Progress in the Fight Against Corruption and Organised Crime and in the Judicial Reform*, Brussels.
- European Commission (Commission Staff Working Document) (8.10.2014), *Albania 2014 Progress Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, Enlargement Strategy and Main Challenges 2014-2015*, Brussels.
- European Commission (Commission Staff Working Document) (10.11.2015), *Albania 2015 Progress Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions*, Brussels.
- European Commission (Commission Staff Working Document) (09.11.2016), *Albania 2016 Progress Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions*, Brussels.
- European Parliament Resolution (30 April 2015) on the 2014 Progress Report on Albania (2014-2019).
- European Parliament (December 2015), *Combating "honour" crimes in the EU*, Members' Research Service.
- Galtung J. (1998), *After Violence: 3R, Reconstruction, Reconciliation, Resolution. Coping With Visible and Invisible Effects of War and Violence*, Princeton, NJ: TRANSCEND.



- Galtung J. (2006), *La trasformazione dei conflitti con mezzi pacifici*, Torino: Centro Studi Sereno Regis.
- Gandhi M. K. (2006), *Teoria e pratica della non-violenza*, Torino: Einaudi.
- Gjeçovi S. (1998), *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër: Botime Franceskane.
- Graziani G. (2015), *Albania andata e ritorno*, RAI.
- Human Rights Council, twenty-seventh session Agenda Item 6, Universal Periodic Review, United Nations Human Rights Council, United Nations.
- Nations General Assembly (7 July 2014), Report of the Working Group on the Universal Periodic Review (Albania).
- Illuminati G., Stortoni L., Virgilio M. (2000), *Crimini internazionali tra diritto e giustizia. Dai Tribunali Internazionali alle Commissioni Verità e Riconciliazione*, Torino: Giappichelli.
- Jaudel E. (2010), *Giustizia senza punizione. Le Commissioni Verità e Riconciliazione*, Milano: O Barra O.
- Justice and Peace Commission of Albania Caritas Albania (2010), *Blood Feud in Albania - Study*, Shkodër: Justice and Peace Commission of Albania Caritas Albania supported by secours catholique (France Caritas).
- Lush G. (2013), *Dashuria që nuk veds. Të mëdhenjtë e shekullit XX*, Prizren: DRITA.
- Mac Ginty R. (2011), *International Peacebuilding and Local Resistance. Hybrid Forms of Peace*, London: Palgrave Macmillan.
- Maggiolini P. (2014), Understanding Life in the Ottoman–Montenegrin Borderlands of Northern Albania during the Tanzimat Era: Catholic Mirdite Tribes, Missionaries and Ottoman Officials, *Middle Eastern Studies*, 50(2): 208-232.
- Martucci D. (2009), *Il Kanun di Lek Dukagjini: le basi morali e giuridiche della società albanese*, Nardò: Besa.
- Martucci D. (2010), *I Kanun delle montagne albanesi. Fonti, fondamenti e mutazioni del diritto tradizionale albanese*, Bari: Edizioni di pagina.
- Meta I. (2015), Project – Rezolute për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri, Tiranë: Republika e Shqipërisë Kuvendi.
- Nagler M. N. (2005), *Per un futuro nonviolento*, Milano: Ponte alle Grazie.
- Narvaez L. (2010), *La rivoluzione del perdono*, Milano: Edizioni San Paolo.
- Operazione Colomba – Associazione Comunità Papa Giovanni XXIII (2012), *Documento descrizione fenomeno 'gjakmarrja' per sensibilizzazione dei membri del parlamento albanese relative alla criminalità in Albania*, Scutari.

- Operazione Colomba - Associazione Comunità Papa Giovanni XXIII – Shoqata Komuniteti Papa Xhovani XXIII (2013), *La Campagna 5000 firme per la vita*, Scutari.
- Operazione Colomba – Associazione Comunità Papa Giovanni XXIII (2014), *Documento descrizione fenomeno “hakmarrje” e “gjakmarrja” per la sensibilizzazione delle Istituzioni Albanesi e Internazionali*, Scutari.
- Operazione Colomba - Associazione Comunità Papa Giovanni XXIII – Shoqata Komuniteti Papa Xhovani XXIII (2014), *Marcia per la pace in Albania “Un popolo si muove per la pace contro le vendette di sangue”*, Scutari.
- Operazione Colomba – Associazione Comunità Papa Giovanni XXIII – Shoqata Komuniteti Papa Xhovani XXIII (2015), *Campagna di Sensibilizzazione 2015 - Un popolo contro le vendette di sangue*, Scutari.
- OSCE – ORGANIZATION FOR SECURITY AND CO-OPERATION IN EUROPE – PRESENCE IN ALBANIA (2014), *REPORT ON BLOOD FEUD IN ALBANIA*, TIRANA.
- OSCE – Organization for Security and Co-operation in Europe – Office for Democratic Institutions and Human Rights – Republic of Albania (2015), *Local Elections 21 June 2015, OSCE/ODIHR Election Observation Mission – Final Report*, Warsaw.
- Qendra “Drejtesi dhe paqe” (2000), *Gjakmarrja në rrethet Shkodër dhe Malësi e Madhe – Studim*, Shkoder: Qendra “Drejtesi dhe paqe”.
- Sadiku M. (2013), *Blood feuds and the rule of law: challenging the Kanun in contemporary Albanian society*, Graduation Thesis in State Building, Nationalism, and Development in Eastern Europe, Master of Arts in Interdisciplinary Research and Studies on Eastern Europe, Università di Bologna.
- Salvoldi G., Salvoldi V., Lush Gj. (1999), *Kosovo, non violenza per la riconciliazione*, Bologna: EMI.
- Scanderbeg I. S. C. (1991), *Albania: The Awakening. Il risveglio dell’Albania*, RAI – TG2 Pegaso.
- Sejko R., Brescia M. (2008), *Albania: il paese di fronte*, Roma: Istituto Luce.
- Servizio Obiezione e Pace – Associazione Comunità Papa Giovanni XXIII (2014), *Caschi Bianchi Oltre le Vendette*, Rimini: Edizioni Sempre.
- Tarifa F. (2008), *Vengeance is Mine: Justice Albanian Style*, North Carolina: Globic Press.
- Tarifa F. (27.07.2014), *Nderi, turpi dhe gjakmarrja. Norma e reciprocitetit dhe një shpjegim funksionalist mbi gjakmarrjen*, *Gazeta Shqiptare*, Tirana: 19-20.



- Testa G. (2015), *Il perdono è un bel guadagno. Un cammino semplice verso la riconciliazione*, Torino: Effatà Editrice.
- Totozani I. (2013), *Raport mbi fenomenin e gjakmarjes*, Tiranë.
- Totozani I. (5 September 2014), *Information presented by the Albanian People's Advocate(Ombudsman)*, Human Rights Council General Assembly (Geneva), Twenty-seventh session Agenda item 6 Universal Periodic Review.
- Tutu D. (2001), *Non c'è futuro senza perdono*, Milano: Feltrinelli.
- United Nations, United Nations Office on Drugs and Crime (2006), *Handbook on Restorative Justice Programmes*, Criminal Justice Handbook Series, New York-Vienna.
- Vickers M. (2014), *The Albanians: a Modern History*, Londra-New York: I.B. Tauris.
- Vickers M., Pettifer J. (1997), *Albania: dall'anarchia a un'identità balcanica*, Trieste: Asterios.
- Villa-Vicencio C., Bendana A. (2002), *La riconciliazione difficile. Dalla guerra ad una pace sostenibile*, Torino: EGA.
- Vuljanić N (9.12.2013), *Motion for a Resolution to wind up the debate on the statement by the Commission pursuant to Rule 110(2) of the Rules of Procedure*, European Parliament Plenary Sitting on the 2013 Progress Report on Albania.
- Winslade J., Monk G. (2008), *Practicing Narrative Mediation: Loosening the Grip of Conflict*, San Francisco: Jossey-Bass.
- Yamamoto K. (2008), *The ethical structure of Kanun and its cultural implications*, Milano: Plangarica.
- Zurlini Panza G. (2013), *Dalla guerra alla riconciliazione. Operazione Colomba: corpo nonviolento di pace in zone di conflitto armato*, Pisa: Centro Gandhi Edizioni.
- Zurlini Panza G. (2017), *Albania: pratiche di mediazione e di riconciliazione tra le famiglie colpite dal fenomeno delle vendette*, Tesi di Dottorato di Ricerca in Scienze Umanistiche, Università degli Studi di Modena e Reggio Emilia.

